


TIRANË-SHKODËR ME JORGE AMADO-N

nga **DHIMITËR SHUTERIQI**

Ai erdhi në Shqipëri, si një ndër aktivistët e Lëvizjes Botërore të Paqes, ku militonin dhe Pablo Neruda, Lui Aragoni, Ana Seghers e të tjerë, shumë si këta. Më 1949 tek ne u mbajt Konferenca I e asaj lëvizjeje, që Amadoja e përshëndeti. Unë duhej ta shoqëroja si shkrimtar, por edhe sepse i kisha nxjerrë “namin” vetes se e njoh (diçka, domosdo!) portugalishten...



Në vitin 1950 ka ardhur në Tiranë shkrimtari më i madh i Brazilit, Jorge Amado (1912-2001) dhe për këtë shkruan në librin e tij me kujtime “Cabotage...”.

Ndërkohë, zonja Mynever Shuteriqi na kishte dërguar një shkrim të pabotuar të profesor Shuteriqit, pikërisht për vizitën që kishte pasur në Shqipëri shkrimtari më i madh brazilian.

TIRANË, 1950

nga **JORGE AMADO**

Më afrohet shkrimtari shqiptar Ismail Kadare. MAi kishte dëgjuar që unë kisha qenë në vendin e tij, po nuk e dinte se kur.

-Kjo ka ndodhur në vitin 1950, mbi dyzet vjet më parë, i dashur Ismail, ecje këmbadoras atëherë.

IN MEMORIAM

(fq. 9)

GIUSEPPE GRADILONE

nga Prof. dr. Valter MEMISHA

Arketipi balador në dy romane të Kadaresë

nga Adil OLLURI

(fq. 6)

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit

ZEF ZORBA, POETI QË SHKAKTOI HABI ESTETIKE

nga Yzedin Hima

“Letërsia e penguar” duhet parë si një mozaik, ku çdo pjesë e tij ka të përbashkëtën dhe të veçantën me të tërën. Ky mozaik i çuditshëm u zbulua, u plotësua dorë pas dorë pas vitit '90.

(fq. 8)

STEFAN ÇAPALIKU

Virusi më
përndjekë, por unë
jam ma i shpejtë

-NGA DITARI I MARTIN CUKUT-

(vijon nga numri i kaluar)

(fq. 10)

Zonja asnjeri
dhe zoti askurrkush
poezi nga

Agron Tufa

(fq. 14)



TË JESH SHKRIMTAR

V. S. Naipaul

Në të vërtetë nuk e di se si u bëra shkrimtar. Mund të jap disa data dhe fakte të caktuara rreth karrierës sime, por vetë procesi mbetet mister...

(vijon në fq. 18)

TREGIME

Roland Gjoza:

Nata më blu se
çdo natë blu

(fq. 17)

Muç Xhepa:

Kinemaja verore

(fq. 16)

Shqiptar Oseku:

Vajza nga jupiteri

(fq. 12)

Xheni Shehaj:

Viti 0001

(fq. 13)

Në vitin 1950 ka ardhur në Tiranë shkrimtari më i madh i Brazilit, Jorge Amado (1912-2001) dhe për këtë shkruan në librin e tij me kujtime “Cabotage...”.

Ndërkohë, zonja Mynever Shuteriqi na kishte dërguar një shkrim të pabotuar të profesor Shuteriqit, pikërisht për vizitën që kishte pasur në Shqipëri shkrimtari më i madh brazilian.

TIRANË-SHKODËR ME JORGE AMADO-N

nga Dhimitër Shuteriqi

Edhe braziliani Amado është një nga të parët shkrimtarë botërorë, që vizitoi Shqipërinë fill pas Luftës.

Ai ishte bërë i famshëm në Evropë përmes përkthimit në Francë të romanit “Bahia e gjithë shenjtoreve”, vepra që e lancoi. Bahia është një nga shtetet e Brazilit federativ; me kryeqytet Salvadorin, në bregun atlantik, në veri të vendit. Romani u përkthye frëngjisht më 1938.

Më parë kisha zbuluar tregimin latino-amerikan, – meksikan, guatemalas, peruvian, ekuadoras etj. Një autori, që më pati bërë përshtypje të madhe, nuk ia harroj as sot emrin, Ikaza, kilian etj. Amadoja ishte një revelacion edhe më i bujshëm. Mos qenë latino-amerikanët që më shtynë të lexoj sa më shumë tregime nga anët e ndryshme të botës, duke nisur me Unamunon e Spanjës, që rri nga rri dhe i rilexoj, është një mjeshtër i pashoq ai, por dhe filozof i madh, kur vihet e skalit edhe tregimin. Kam vazhduar me Skandinavët e, domosdo, me

Heminguejin e Pirandelon e Elin Pelinin këtu pranë nesh. Lexojeni këtë bullgar, se ia vlen vërtet. Në çdo ballkanas gjen diçka si nga Shqipëria; në çdo shqiptar gjen diçka si nga gjithë Ballkani, më duket mua. Por e kisha fjalën te Zhorzh Amadoja.

Ai erdhi në Shqipëri, si një ndër aktivistët e Lëvizjes Botërore të Paqes, ku militonin dhe Pablo Neruda, Lui Aragoni, Ana Seghers e të tjerë, shumë si këta. Më 1949 tek ne u mbajt Konferenca I e asaj lëvizjeje, që Amadoja e përshëndeti. Unë duhej ta shoqëroja si shkrimtar, por edhe sepse i kisha nxjerrë “namin” vetes se e njoh (diçka, domosdo!) portugalishten. Braziliançëja është një portugalishte më e kurtë në tingëllim se gjuha e Lisbonës dhe e dëgjoja në BBC gjatë Luftës. Portugalishten nisa ta kuptoj duke u shoqëruar me disa studentë të shtetit jug-perëndimor të Evropës, po dhe duke u orvatur të lexoj një të përkohshme të një intelektual guximtar, i cili mbante të njëjtin emër si të diktatorit katolik Salazar, e përkohshme që e linin të lundronte

përmbi ujërat e lumit Tag, perëndia s’e dinte.


Duhej, pra, t’i flisja portugalisht Amados! Torturohesha, por ai ngulte këmbë, me “domosdo!” Kur do të përshëndeste mitingun që u mbajt në Sheshin Skënderbej, fjalën e shkroi frëngjisht. M’u shkri gjaku, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kur dolëm në ballkonin e Bashkisë dhe nisi të shprehet portugalisht dhe më urdhëroi fort, sa ta ketë dëgjuar ndofta dhe publiku, “portugalisht!”, mbeta pa gjak, fjalë e vërtetë. Po lahesha në djersë. S’e gjeja fjalën shqip, e zëvendësoja, s’e zëvendësoja dot, e përktheja kuturu. Më shpëtonin duartrokitjet e dëgjuesve, që dhe s’dëgjonin dot. Shokët shqiptarë që na rrethonin, duartrokisnin e s’kishin kohë të kuptonin ndonjë “nonsens” mbi Paqen. Sigurisht, “Paqen” nuk e zëvendësova me “Luftën”, po kur flitet për Paqe, nuk ke si të mos flasësh edhe për Luftë! Tema më “mbronte”.

Kur Amadoja u largua nga Shqipëria, ai më la “porosi” “t’i rikthehem portugalishtes”. Mua, që kam qenë i papërtuar, m’u gudulis sedra. Qëlloi që erdhi në Shqipëri një zonjë lizboneze, që, domosdo, bënë ta njoh edhe unë. Iu luta të më dërgonte një fjalor portugalisht-frëngjisht e anasjelltas, po të mundte edhe romanin “Silva”, – pylli, – frëngjisht e kanë përkthyer “La foret vierge” dhe jo “La jogle”. Brazili është vend xhunglash. Njëpër to kishte vuajtur pa masë, sepse i vajti mendja të kalojë ca kohë te një xhajë i veti, Fernando de Kastro, autor i librit që i dha famën në të nisur të viteve ’30. Fjalorin e kam, kam edhe disa libra në gjuhën e lakmuar, po që s’i lexova dot, le të qeshë i papërtuar, siç u lëvdova.

Me Amadon vajta në Shkodër, më duket dhe në Vlorë e gjetiu. E shetita diçka, se kohë kishte dhe vendi i pëlqeu. E paharrueshme ka mbetur për mua vajtje-ardhja Tiranë-Shkodër-Tiranë. Ishte hera e dytë apo e tretë që vizitoja qytetin aq të pasur për histori e kulturë, për jetë nga më tërheqëset, për gjuhën aq të përpunuar, – palë në gojën e grave! – të qytetit, dhe aq variante të krahinave që e rrethojnë, gjer të Pukës e të Mirditës.

Duhet ta merrni me mend, se ai udhëtim, është si një “paradë” mode, që të përdor një fjalë të ditës sot, kur bëjmë parada mode jo vetëm në kryeqytet, po ku ta dish? Kur nisesha drejt Veriut, pa dalë mirë nga Tirana, takoja jakucen e parë të zezë, me xhufka krahëve dhe me thekë shpinës. Me opinga, burri sikur kërcen dhe pendebrekët e bardha e të gjera e bëjnë të zërë tokë pa zarar. “Çfarë mrekullie!” nxjerr kokën në dritare të makinës Amado dhe unë jam i detyruar ta tërheq prej krahu, se mos ia merr kokën ndonjë dru plepi anës rrugës, apo t’i them shoferit të ndalet, që miku të soditë mrekullinë që ecën. “Kështu s’vemë as nesër në Shkodër!” nëpërdhëmb shoferi, që ku ta dish se çfarë interesi ka ai për Shkodrën. “Po kur të dalim në Zadrime tonë, ç’ka për të bërë ky shok? Në Zadrime kena se ç’kena veshje ne Shkodra, ama të grave.” Na doli shkodran shoferi. Në Zadrime, ngjyrat ua shkoshin atyre të ylberit. Amadoja gumonte “ah! ah!” Shoferi ndalte në çdo njëqind-dyqind metra, – “janë flutura, more zot! Ajo anë Mirdite sikur s’na priti mirë.” Kishim parë në pazarin e Milotit vajza mirditore të veshura me të zeza, “që të mos i merrnin mësysh”, kishte thënë shoferi, që ua çmoi bukurinë.

Pazari i Milotit ishte diçka e mahnitshme, me kostumet e mallrat. Gratë me çervet gjer nën brez mbas shpine. Xhufkat e kuqe të brezit e të xhokave flakë e që se si tunden e shkunden, të ratë se si



merren vesh “çë-çë” kokë më kokë, midis asaj potere britmash, këmborësh, përmes hasrave, samarëve, perustive. Unë për këmborë e zile kam shkruar në një tregim timin, dhe mund të shastis pazareve kur i dëgjoj. Amadon mezi e shkulum vendit. “Jemi në mesin e udhëtimit. - Nuk mund të flegmë në makinë?” pyet ai, që s’do të shkulet. “Do të shohësh pazarin e Shkodrës, ai është seç është”, i tregon me duar e me këmbë shoferi dhe i përkthej unë (frëngjisht). “Nuk mundet ta bëjmë dy ditë këtë rrugë?” mjerohet miku. “Po kemi rrugë edhe për gjetiu nëpër Shqipëri”, ia bëj unë si me të lutur. Unë i premtos vetes se do të blej ndonjë ditë “një palë” këmborë të tilla. I kam dalë fjale vetes. Po Maks Velos, që vinte për të blerë këmborë në Milot, – apo s’ishin “kryevepra”, – mund që i kujtohet se kemi vajtur bashkë. Amadoja iku i pakënaqur, edhe pse do të kishte dashur t’i dëgjojë ata tinguj midis një tufe blegërimash.

Pamë edhe njerëz të veshur si mos më keq. Ku kishte rënë krenaria shqiptare! Unë i isha lëvduar mikut, se “çdo shqiptar e ka në arkë një takëm të ri”. Po këta, të rreckosurit! Po “zonja të tilla” me funde të bardha që nxinin? “Ditë pune”, shpjegoi shoferi, që prishte buzët.

Hyrja në Shkodër ishte “e papërshkrueshme” urdhëroi Amadoja të ndalet makina. Lumi Buna, “si një farë Danubi”; dalanët, që i shpjegoja se ç’janë. Kemi ngrënë qefull të pjekur në tullët në ato dalane të nesërmen, apo ç’kemi ngrënë? Gratë elegante e moderne dhe të tjera me çarçaf, nëpër rrugica, ku shtëpitë janë më të ulëta se muret që i rrethojnë. Ai kishte shastisur kundrejt kështjellës së Rozafës, që tha, përpara një porte të madhe me hark, nga ku dukej një shtëpizë tutje, midis gjelbërimit të luleve: “Këtu jetohej midis kështjellave! More ç’porta! More ç’mure!” Gra të të gjitha kostumeve. “Do t’i bëjmë sehir në pazar”, e nguti shoferi makinën. Burra të lartë gati gjer mbi mure, veshur bardhë e zi, me një takie sa një tas, që se si qëndronte mbi kokë. Na zuri syu dhe një a dy makina, dhe ndonjë biçikletë. Në pazar nuk mund të shkonim, ai duhej të ishte mbyllur tani: kishim ardhur me shumë vonesë. U vendosëm në një si hotel në qendër të qytetit dhe ramë të flemë herët, të lodhur nga rruga me ndalesat e saj interesante. Të nesërmen na zgjuan kambanat e shumta që binin. Çfarë feste ishte? Duke u vërtitur edhe një herë nëpër qytet, kaluam pranë një xhamie me dy minare. “Përse dy e jo një?” pyeti miku. Shoferi dinte se në Stamboll kishte xhami edhe me tri minare. Një mësues shkodran që e njihja, na tregoi “rrugët e Kolë Idromenos”,

siç i quajti ai, sepse shumë shtëpi të tyre kishin Kolën si arkitekt. E dija se Kola kishte qenë një piktor i zoti, kisha parë një tablo të tij që numërohej e humbur, por që u gjet nëpër depot e Ministrisë së Arsimit, “Dasma Shkodrane”. Ai s’paska qenë vetëm piktor, por edhe arkitekt, por edhe fotograf, – Shkodra ishte vendi i disa fotografëve me emër, përveç të famshmit Marubi; – Idromenoja ishte një artist “i kompletuar”, siç e quajti mësuesi: ai merej nuk di me çfarë zanatesh. Nuk më përmendet të kishte muze të shtetit në Shkodër, ku të shihnim ndonjë pikturë të tij.

Ndërkohë, rrugëve dhe rrugicave të Shkodrës, takonim fshatarë e fshatare që ishin drejtuar nga pazari, me gomarët e tyre ose me nga ndonjë kosh apo thes në krahë. Ishin veshur si për ditë feste. Burrat bardhë e zi, me takie, gratë e tërë ngjyrave, mëngëpërveshur. Zhurma e pazarit dëgjohej pa afruar mirë. Në një fushë ishin shtruar shitësit me mallin përpara. Zarzavate shumë, sa

s’kisha parë ndonjëherë në pazarin e ri të Tiranës. Mund të shihje gra që nuk ishin munduar gjer aty më shumë se me disa tufa lëpjetë e majdanos e nenexhik. Mund të shihje burra përpara thasësh të mëdhenj me misër apo me tagjira. Amadoja shante veten se nuk kishte ardhur në Shqipëri me një aparat fotografik. Një aparat nuk qeshë i zoti ta siguroj as në Shkodër. I zoti kërkonte shumë qira, se donte ta punonte vetë. Atje ishte një Zadrinë e tërë e grumbulluar dhe fushat e tjera përreth, malësitë e Maleve dhe të Anamaleve, si po i quaj, shumë që nuk shisnin as nuk blenin, po kishin ardhur në Shkodër për punë të tjera e për t’u parë, si thoshte mësuesi vendas. U endëm e u çendëm me makinë e më këmbë dhe, në fund, pamë katedralen, një godinë kolosale, që na treguan se ishte më e madhja kishë katolike në Ballkan.

Duhej ta linim Shkodrën, me gjithë se miku ynë ndalej përpara çdo gjëje që e tërhiqte. Nëpër argjendarët e qendrës së qytetit ai kaloi një pjesë të kohës. Kishte çibukë qelibari që s’i kishte imagjinuar dot të stolitur me

serm. Vathë e gjerdanë e unaza me “gurë të çmuar”, sigurisht pa ndonjë vlerë të madhe, sepse ua shihnim fshatareve më të zakonshme që kalonin. Sidoqoftë, ajo mjeshtëri e argjendarit ruante akoma punime jo të zakonshme nëpër vitrina, gjer edhe ndonjë pushkë të moçme të gjatë pabesisht, revole brezi që t’u bëheshe merak, sepse shihnim nëpër brezat e shkodranëve të fotografuar e të ekspozuar nëpër disa fotografë, me tërë stolinë e xhamadanëve, brezave, qelesheve, çibuqeve, në të cilat opingave ua kishin zënë vendin me kohë “kundrat” moderne.

Mos e kaluam atë natë në një si hotel të Krujës? Kalaja me atë kullën e lartë majë shkëmbit, rrëfente se Skënderbeu mund ta zbulonte armikun që po i turrej që larg e më larg kryeqendrës së tij, fole shqiponjash. Syri të kapte, që nga gryka e Matit e gjer në Karaburun, një bregdet të shpalosur, si një hartë xxx vigane, det i kaltër, fusha të gjelbërta, lartësi të mjegulluara. Me kohë të mirë, thoshin se shihje që andej nga Italia. “Një vend i vogël me një variacion të tillë!” habitej Amadoja. “Kushedi se si e ndien njeriu veten në hapësirat e një kontinenti?” përpiqesha ta imagjinoja unë. “S’të lënë xhunglat ta bësh syrin dylbi gjer atje”, tregonte Amadoja largësitë tutje e më tutje. xxx Në belveder të tillë s’jam ngjitur kurrë.

Jam takuar me Amadon dhe tjetër herë. Udhëtimi ynë Tiranë-Shkodër sikur nuk ishte një pjesë e kujtimeve të pashlyera të tij, po sikur i zgjohej nga fantazia, ishte

bërë “pjesë e fantazisë së tij”, më thoshte. Për të ma kthyer nderin me nder, më dërgoi një ftesë, që të vete e të marr pjesë në një mbledhje panamerikane të paqes në Santiago të Kilit. Letrën e firmonte dhe Pablo Neruda, të cilin për së afërmi nuk e kam njohur, po dorën ia kam dhënë. Ja një udhëtim fantastik që më priste, gjer “në fund të botës”. Duheshin me mijëra dollarë: arka e shtetit nuk u çel. Amadoja nuk dinte se si të më tregonte sa fort i vinte keq. E “sigurova” se nuk kishte qenë punë paresh, po “hall shëndeti”. Sigurisht që s’më ka besuar. Atëherë u zbulua, se në Santiago gjendej një piktor shqiptar, që kishte bërë emër? Ndofta. Ai kishte shkruar një letër plot mall për Shqipërinë, ku “do të vinte, do të vinte!”, por as ai nuk erdhi nga aq larg. Punë shëndeti, hall paresh?

Amadoja më se një herë më përmendte varfërinë e shqiptarit, që e mbante përherë në arkë një thesar, i cili ishte një kostum të mrekuallueshëm.



TIRANË, 1950

nga **JORGE AMADO**

Përgatiti dhe përktheu Bujar Hudhri

Në një pritje të organizuar nga presidenti Miterrand për nder të dyzet shkrimtarëve të huaj, të ftuar në hapjen e programit «Fureur du Livre»¹ – një trill i ministrit të kulturës Jack Lang, – më afrohet shkrimtari shqiptar Ismail Kadare. Ai kishte dëgjuar që unë kisha qenë në vendin e tij, po nuk e dinte se kur.

-Kjo ka ndodhur në vitin 1950, mbi dyzet vjet më parë, i dashur Ismail, ecje këmbadoras atëherë.

Unë erdha në Shqipëri në Kongresin e Mbrojtjes së Paqes. Ky vend më robëroi: ullishtat, porti në breg të Adriatikut- ai nuk ishte më i madh se Ilieusi im i lindjes,- një popull krenar për fitoret e tij të pak mëparshme në luftë me Hitlerin dhe Musolinin. Mjerim dhe shpresë. Kryeqytetin e vogël e përshkuam në këmbë me Wanda Jakubowskan, nga njeri skaj në tjetrin nja dy orë. Atë kohë shkruajta disa pasazhe lirike për Shqipërinë- duhet të keni parasysh edhe entuziazmin që më kishte veshur sytë. U njoha me vetë Enver Hoxhën, fola me të...

-S'ka mundësi! Vërtet ju priti?- u habit Ismaili, i cili e mban mend se sa i paafrueshëm ka qenë tirani i Tiranës.

-Po unë përfaqësoja këshillin Botëror të paqes...

Enver Hoxha jo vetëm më priti, por edhe më ofroi një gotë çaj dhe biseda jonë zgjati më shumë se një orë. Ai mburrej për triumfet e shkuara, ndau me mua planet e tij grandioze për të ardhmen, hymnizonte Stalinin, por shkoi deri aty sa të kujtonte Fuad Saadin, mjeku nga San-Paulo, me të cilin në vitet studentore kishin jetuar në të njëjtën dhomë të një pensioni të lirë në Marsejë (apo Lion?). Kur u ndamë, Enver Hoxha mori pësëri pamjen e një statuje dhe më urdhëroi t'ia transmetoja Prestesit² këto fjalë:

-I thoni shokut Luis Karlos, ta mbajë mend e të mos e harrojë kurrë: nuk duhet të trembet nga gjaku. Pa derdhur shumë gjak s'ka revolucion, asgjë nuk arrihet.


Marrë nga libri me kujtime
Jorge Amado, "Lundrim kabotazhi"

1. "Libri është ngjarja e vitit" (fr.)



Wanda Jakubowska


2. **Wanda Jakubowska.** Një nga regjisoret më të shquara të kinematografisë polake të pas luftës dytë botërore, "gjyshja e kinemasë polake". Në vitet e luftës u burgos në Osvencin, përjetoi tmerret e kampit të vdekjes dhe u rithye në kinema.



Luís Carlos Prestes




3. **Luís Carlos Prestes** (1898–1990), veprimtar i lëvizjes punëtore dhe komuniste braziliene dhe ndërkombëtare. Për gjysmë shekulli ka qenë kryetari i Partisë Komuniste të Brazilit. Në vitin 1980 akuzoi partinë e tij se kishte braktisur dogmën marksiste. E larguan nga udhëheqja dhe e përjashtuan më 1984. Vdiq në vitin 1990, në moshën 92 vjeçare.





Kam qenë gjashtë vjeç, kur u krye Revolucioni i Tetorit, i cili në emër të punëtorëve shpalli në Rusi pushtetin sovjetik. Së shpejti unë mbush tetëdhjetë vjet dhe rrotull shoh që po shëmbet rregulli i vendosur prej këtij revolucioni dhe i përforcuar nga bilanci i Luftës së Dytë Botërore. Në Europë po lind realiteti i ri gjeografik dhe politik. Po shpërbëhen perandori, po bien regjime. Tregtarët e shkathët po shesin si suvenire copëra të “perdes së hekurt”,- rrënojat e murit të Berlinit. Kurse ajo ideologji që na paraqitej dikur si kristal, e pastër steril dhe shkencërisht e kulluar, që turbulloi shpirtitn jo vetëm të një inteligjenti, që vuri në lëvizje dhe ngriti në luftë për liri dhe lumturi masat gjigante njerëzore, që e ndau botën më dysh, duke kufizuar qartë “të mirën” dhe “të keqen”, kjo ideologji, pra, doli një himerë dogmatike. Dhe për fat të keq, nuk na shpuri në liri dhe lumturi, por në tirani. Jo më kot, më datën 7 nëntor, moskovitët dolën në Sheshin e Kuq, duke mbajtur parullën “Proletarë të të gjitha vendeve, na falni!”» Iku në harrim ajo që dukej e përjetëshme. Po ndodh e padëgjua dhe e pamendueshmja. Në sytë tanë, në ekranet e televizorit po bëhet historia. Ndryshime të pabesueshme- dhe me një ritëm të tërbuar, kur dita vlen një vit, kurse java një shekull. Më vjen keq, që nuk do të mund ta shoh deri në fund. Sa do të doja!

(Fragment nga hyrja e librit me kujtime "Lundrim kabotazhi" i shkrimtarit Jorge Amado)



Arketipi balador në dy romane të Kadaresë

nga Adil OLLURI



Ismail Kadare, emër i përveçëm i letërsisë shqipe, i njohur, i përkthyer dhe i vlerësuar anëkend globit, tashmë është një pasaportë e letërsisë dhe kulturës sonë në botë. Ai ka shkruar një varg romanesh që edhe sot e kësaj dite lexohen me ëndje dhe me interesimin e pasosur të lexuesit tonë dhe të atij të huaj. Leximi i prozës së tij shkakton atë që studiuesit e cilësuan si *tronditje estetike*[7]. Është thënë dhe është shkruar se ai nuk është shkrimtar eksperimentues, por shkrimtar që vazhdon ta ruaj fabulën, ta ndërtojë kompozicionin e fortë, ta ketë rrëfimin realist dhe përshkrimin detajist[8], duke u vënë në paralele krahasimi, sa i përket këtij aspekti, me të mirënjohurit e letërsisë së përbotshme, si G. G. Marquez, M. Vargas Llosa, G. Gras etj. Gjithashtu, për shkak të rrethanave të krijimit, ai është vënë edhe në paralele të tilla me shkrimtarët disidentë, si M. Kundra, A. Solzhnjecin, B. Pasternjak etj, duke u cilësuar edhe si një lloj “*arketip*” botëror, që bëri art nën kushtet e një prej sistemeve më drastike dhe që fatmirësisht e kemi gjallë edhe sot mes nesh[9].

Dy romanet e tij, ndër më të arrirat në planin artistik, “Ura me tri harqe”[10] dhe “Kush e solli Doruntinën”[11] janë të ndërtuara mbi bazën e dy baladave ndër më të njohurat të epikës sonë legjendare, siç janë balada e ringjalljes së vëllait të vdekur apo e njohur edhe si balada e besës së dhënë, si dhe balada e flijimit apo e murimit. Ky shkrimtar ka edhe një sërë romanesh të tjera që mbështeten në folklor, si “Dosja H”, “Tri këngë zie për Kosovën”, “Muzgu i perëndive të stepës” etj, por dy romanet për të cilët folëm më lart janë të dallueshme prej tyre m’u për shkak të substratit legjendar, për dallim prej romaneve të tjera ku substrati i epikës historike është më mbizotërues.

Shkrimtari për t’i ndërtuar romanet e tij e merr vetëm lëndën e parë, motivin nistor, të cilit i jep kah tjetër dhe e zhvendos në kohë dhe hapësira të ndryshme. Nisur nga kjo, edhe pse arketipi bazik, baladat legjendare, janë të padefinuara në aspektin e kohësisë dhe vendndodhjes, Kadare rrëfimin e tij e përcakton dhe e vendos kohësisht në mesjetë (koha) dhe në aspektin hapësinor ngjarjet e dy romaneve zhvillohen në Arbëri (vendi), si dhe një pjesë e rrëfimit të “Kush e solli Doruntinën” zhvendoset në Bohemi (Evropë qendrore), në mënyrë që të ilustron martesa e motrës në një vend të largët, që për të ardhur te të vetët, familja e saj, i duhet trembëdhjetë ditë e trembëdhjetë rrugë, duke i kaluar malet dhe fushat e disa mbretërive. Kjo bëhet edhe për ta arsyetuar mungesën e informatës për tragjedinë familjare nga ana e Doruntinës, meqë e degdisur në një vend aq të largët, që nuk ka asnjë lidhje me vendin e saj të origjinës, një mungesë e tillë del të jetë e motivueshme. Te “Ura me tri harqe”, përpos Arbërit, si vendndodhje konkrete e ngjarjes shfaqet Ujana e keqe, një topos imagjinar kadarean, që është vendi mbi të cilin ndërtohet ura.

Nëse i rikthehem edhe njëherë interpretimit të dimensionit kohor të këtyre dy romaneve, mund ta hetojmë se ngjarja e rrëfyer te “Kush e solli Doruntinën” është më e hershme se sa ajo te “Ura me tri harqe”. Këtë e themi duke u bazuar në të dhënë se personazhet e romanit të parë përballen me pushtetarët dhe peshkopët bizantinë, për dallim prej atyre të romanit të parë që bien ndesh edhe me pushtetarët otomanë, të cilët nuk janë të pranishëm në romanin paraprak.

Dihet mirëfilli se vendi ynë, Arbëri i romanit, përpara se të pushtohet nga Perandoria Osmane ishte me shekuj të tërë nën thundrën e asaj bizantine, andaj një kërkim i tillë na jep të drejtë në përcaktimin se cili roman e trajton kohën më të hershme e cili atë më të vonë, si dhe na i plotëson pasqyrën e kohështrirjes së rrëfimit në të dy romanet. Ky është një ilustrim i dukshëm i transformimit të arketipit të hershëm të tyre, baladave parake, ku nuk ka ndonjë kohë dhe hapësirë të tillë.

Përcaktim kohor dhe hapësinor i rrëfimit na dërgon te një dimension tjetër i kuptimësisë së tekstit letrar të shkrimtarit, që siç vihet re ka një intencë ta quajmë të historicizmit. Një qasje e tillë, që është tipike për diskursin narrativ të Kadaresë, i cili, shikuar nga kjo perspektivë, ka për synim që atë që e njohim si mitike, gojëdhënë, substrat folklorik, të mundohet të na i paraqes si një ndodhi historike, të mbështjellë me vëllon e nacionales dhe të autentikes. Këtë e themi për shkak se autori duket sikur insiston që duke e shfrytëzuar arketipin balador të na i paraqes përmes diskursit të tij artistik përballjen e njerëzve të vendit të tij me dy perandori, nga më të mëdhatë që njeh historia e njerëzimit.

Flijimi dhe krimi

“Ura me tri harqe” është botuar për herë të parë në vitin 1978, si triptik, ku ishin të përfshirë edhe “Pashallëqet e mëdha”, që më vonë u ripagëzua nga autori si “Kamarja e turpit”, dhe “Muzgu i perëndive të stepës”. Është cilësuar si triptik, ngase në të parën flitet për një periudhë bizantine e paraosmane (osmanlinjtë vetëm i ishin afruar Arbërit), në të dytën për atë osmane dhe në të tretën për atë sovjetike, tri epoka që e shënjojnë historinë kombëtar, sikurse tri harqet e urës fikzionale.

Miti i flijimit është motiv i kahershëm arketipor


jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në atë të përbotshme. Mjafton ta kujtojmë tragjedinë e antikitetit grek “Ifigjenia në Aulidë” të Euripidit, ku mbreti Agamemnon flijon të bijën për hir të hyjnive, në mënyrë që ata t’ia bëjnë më të lehtë rrugëtimin për në luftë dhe mposhtjen e trojanëve në përgjithësi. Pra, siç shihej flijimet u bëheshin hyjnive apo edhe shpirtrave të paidentifikuar që rrezojnë themele urash, siç ngjet te “Balada mbi Urën e Shejtit”[12], për të cilën theksohet se është substrati gojor më i afërt në të cilin u mbështet Ismail Kadare[13]. Në folklorin tonë ky arketip, përpos që e ka motivin e flijimit e të sakrificimit, ai e ka edhe atë të murimit të qenies njerëzore, që në disa variante a këngë popullore del në themelet e një ure e në disa në muret e një kalaje. Miti a legjenda e jonë më e njohura e kësaj natyre është ajo e Rozafës a Rozafatit, e ndërlidhur me veriun dhe qytetin e Shkodrës, që flet për flijimin dhe murimin e nuses së vëllait të vogël, bashkëshorti i së cilës ishte i vetmi nga tre vëllëzërit, që e kishte mbajtur besën. Andaj, përpos flijimit e murimit, këtu e kemi edhe motivin e besës, një nga elementet më karakterizuese të eposit tonë legjendar.

Ismail Kadare, në romanin e tij të lartpërmendur, i rreket procesit të demitizimit të legjendës së murimit, duke na i dhënë një pamje të një vrasjeje të zakonshme, të kryer nga grupe të interesit që kërkonin vazhdimin e dominimit, siç ishte “Lundra dhe trape”, një kompani e transportit ujqor, e cila në këtë rrëfim bie ndesh me muratorët apo ndërtimtarët e rrugëve dhe urave. Pra, kemi një ballafaqim biznesor në mes të ujqorëve dhe rrugorëve, siç i emërton bukur autori. Është ballafaqim i tillë, meqenëse me ndërtimin e urave pakësohej ndikimi dhe fitimet materiale të “Lundra dhe trape”. Urën e Ujanës së keqe, toposit fiktiv kadarean, sugjerohet se e shembin ujqorët dhe rrugorët, në shenjë hakmarrjeje e vrasin njërin nga punëtorët e tyre, Murrash Zenebishin, të cilin e murojnë në themelet e urës, duke u bazuar në legjendën e kahershme të flijimit. Sikundër është shkruar për këtë roman, shkrimtari këtu e zhvesh rrëfimin nga mistikja dhe ngjarjet i kthen në të rëndomta dhe reale[14].

Murrash Zenebishi është viktimë e një konflikti në mes të së resë dhe të së vjetrës, vrasje e të cilit arsyetohet e mistifikohet nga dominuesit e rinj, për të na dhënë idenë se secili sistem diktati ndërtohet mbin themelet e përgjakura, njëjtë sikurse ura e Ujanës së keqe. Ai është një personazh simbolik i këtij rrëfimi, i cili në fillim duket se është fare episodik, duke mos qenë pjesë e veprimit dramatik të romanit, por ajo që i ndodh atij e zhvillon dhe e dërgon tutje veprimin. Marashi është çelësi përmes të cilit zbrërthet dhe zhbëhet mitikja. Ai, siç thotë Mateo Mandala, është një i vdekur pa varr, simbol i mangësisë dhe i dështimit, diku mes jetës dhe vdekjes[15].

Përpos relacionit intertekstual me eposin legjendar, “Ura me tri harqe” ka një relacion të tillë, madje në formën eksplicite, me “Mesharin” e Gjon Buzukut, që bëhet përmes personazhit-narrator Gjon Ukcames, që është edhe vetë murg dhe dijetar, dhe si i tillë i identifikueshëm me autorin e librit të parë të shkruar në gjuhën shqipe.

“Unë, murgu Gjon, biri i Gjorg Ukcames, tue kujtoun se në gluhën tonë ende s’ka gjë të shkrueme për urën mbi Ujanën e Keqe e, aq më keq, kur për të vazhdojnë



të thuren gojëdhëna e histori të paqena e gjithfarë dokrrash, tani që ajo mbaroi së ndërtuari, madje, që u spërkat dy herë me gjak, në themel e në kulm, vendosta ta shkruaj kronikën e saj.[16]"

Këtu e shohim një formë të raportit të drejtpërdrejtë mes dy teksteve, që del të jetë e qëllimshëm, meqë edhe te romani është paragraf nistor, sikurse te "Meshari" i Buzukit. Ky paragraf jo vetëm që gërshëtohet dhe bëhet pjesë funksionale e tekstit kadarean, por edhe na jep dy informacione mjaft të rëndësishme, e para ka të bëjë me planin formal, ndërsa e dyta me atë ideor. Së pari, e kemi parasysh tipin e *narratorit intradiegetik*[17], që ndodhet brenda ngjarjes dhe rrëfen për gjërat që i ka parë. Po ashtu, qysh në fillim na jepet sinjali për intencën e formës, që natyrisht është intencë fikzionale, që të na i prezantojë rrëfimin si një kronikë të shkruar nga Gjon Ukcama, murg i Arbërit dhe njëlloj këshilltari i udhëheqësit, princit Stres Gjikondi. Së dyti, përmes këtij paragrafi nistor shohim një hyrje të shkurtë në botën e një demitizimi, që do të ndodh më pas, si dhe jepen shenjat e një krimi, për të cilin folëm më lart. Me një fjalë, teksti nistor i këtij romani të Kadaresë mund të lexohet edhe si një formulë, përmes së cilës mund ta interpretojmë dhe analizojmë atë.

"Besa" e Konstandinit dhe trileri narrativ

"Kush e solli Doruntinën", njëri nga romanet kryesore të Ismail Kadaresë, e ndjek linjën e njëjtë të zhveshjes së mitit dhe rrëfimit bazik të marrë si substrat nga balada epike rreth Konstandinit dhe Doruntinës, që në letërsisë tonë popullore del në variante të ndryshme, duke iu ndryshuar emrat e personazheve, zakonisht emri i motrës, që siç e thamë edhe më sipër, përpos si Doruntinë, herë del si Garentinë e herë si Dhoqinë, varësisht prej rrethanave dhe hapësirës gjeografike të shtrirjes së kësaj kënge epike. Madje, motërzimi më i ndryshuari nga të gjithë është "Kënga e Halil Garrisë", ku përpos ndryshimit të emrit të personazheve, shohim edhe ndryshimin e identitetit religjioz e kulturor të personazheve.

Demistifikimin e arketipit shkrimtari ynë e bën duke e ndërtuar intrigën e re mbi të vjetrën, të cilën e realizon edhe te romani paraprak, por se këtu e shtron pyetjen çdo të ketë ngjarë pas rrëfimit legjendar, çdo të ketë mundur të ndodhte pas asaj që e jep balada për Konstandinin dhe Doruntinën. Andaj, për dallim prej "Urës..." ku shtrohet dilema rreth asaj se ç'ngjau gjatë rrëfimit arketipor, te "Kush e solli Doruntinën" shtrohet dilema se ç'ngjau pas këtij rrëfimi. Gjithashtu, për dallim prej "Urës..." në këtë roman e kemi të pranishëm elementin e fantastikes, të munguar në të parin, në të cilin, edhe pse në një pjesë të tij, flitet për sajesa fantastike, si "shpirtrat e ujit", ato nuk arrijnë të na fusin në një botë e ambient gotik, siç ngjet te "Kushi e solli...", që është element atipik për letërsinë e deriatëhershme shqipe.

Ky roman, për të cilin me *elementin mbizotërues dhe më të pranishëm se në veprat e tjera*[18] te të njëjtin shkrimtar, e ruan vetëm atë që do ta cilësonim si bërthamë arketipore, ngase edhe këtu, njëjtë sikurse në baladë, vëllai i vogël, Konstandini, ngrihet nga varri dhe e sjellë të motrën e vetme, të martuar në një vend të largët, për ta mbajtur besën që ia kishte dhënë të ëmës. Edhe këtu, sikurse në baladë, i kemi nëntë vëllezërit e vdekur, nënën plakë të mbetur vetëm, si dhe dialogun e saj me Doruntinën, që është i njëjti me atë të legjendës. Procesi i ndryshimit nis nga këtu, nga bërthama, ku për dallim prej arketipit përcaktohet vendi ku është martuar e motra, e që është Bohemia e largët, një vend në Evropën qendrore. Po ashtu, në roman vdes nëna dhe Doruntina, gjë që nuk ngjet në legjendë. Këto janë shenja të vogla të trajektoreve së zhbërjes mitike, sepse ato të mëdhatë i japin një dimension krejt tjetër romanit, duke e bërë që të duket edhe si triler policor, që e ka pikësynim zbrërthimin e



një enigme, por edhe si roman me një bazament të fortë të ideologjisë nacionale.


Që nga fillimi dhe deri në fund struktura e këtij narracioni i rreket një qëllimi që t'i jap përgjigje dhe ta zbulojë një të fshehtë, një enigmë, që ndërthen në vete pyetjen në bazë të së cilës është titulluar edhe romani: *Kush e solli Doruntinën?* Kësaj pyetje të mbuluar me mister synon t'i jep përgjigje kapiten Stresi, një polic hetues, që është një nga personazhet më të veçanta në tërë krijimtarinë imagjinatave të Ismail Kadaresë. Një qasje e tillë investiguese i jep kësaj vepre të këtij shkrimtari ngjyrimë të zhanrit të romanit policor, me elemente të një trileri që e mbanë pezull lexuesin me befasi të shumta. Andaj, zhanri policor, trileri, e befasishmja, sikurse edhe fantastikja, e bëjnë këtë roman të veçantë, jo vetëm në mesin e veprave artistike të Kadaresë, por edhe të mbarë letërsisë shqipe.

Stresi, kryepersonazhi i romanit, një zyrtar i Principatës së Arbërit, nuk i beson së dhënës së përhapur se Doruntinën e ka sjellë në shtëpi vëllai i saj i vdekur, së cilës i beson shumica e popullit, duke i kënduar edhe këngë edhe duke e shndërruar në një legjendë. Ai, si një tip racional që i beson vetëm faktit të parë dhe të prekur, orvatet që të gjejë shenja të argumentueshme që do t'ia jepnin atij rezultatet për ta zhbërë enigmën. Dyshon se atë e ka sjellë ndonjë

njeri që do të mund te ketë qenë i dashuri i saj, por edhe ndonjë i afërm i vëllait.

Përveç dyshimeve dhe kërkimeve të Stresit, në këtë roman shpaloset edhe një hamendësim tjetër dhe mjaft domethënës. Ndihmësi i Stresit, duke e bindur edhe vetë eprorin e tij, vë dyshimin për një marrëdhënie incesti në mes të Doruntinës dhe Konstandinit, meqë ishte i vëllai që nuk e pranonte asnjë krushqi dhe ishte i vëllai që këmbëngulte për krushqinë e largët, në mënyrë që t'i shmangej kontaktit të shpeshtë fizik me të motrën. Shikuar në këtë aspekt, mund të themi se ndërputja e motivit të incestit është shkalla më e skajshme e ndryshimit që i është bërë arketipit balador, jo vetëm në mesin e veprave të Kadaresë, por ndoshta edhe në mbarë letërsinë e shkruar shqipe. Po ashtu, hamendësimi i incestit në mes të dy personazheve arketipore të eposit tonë legjendar është një risi motivore dhe thyerje e një tabuje tematike në letrat tona, marrë parasysh kohën kur është shkruar romani "Kush e solli Doruntinën".

Është me interes të thuhet këtu se përpos ndryshimeve që krijimi artistik i bën atij gojor, në këtë roman të Kadaresë shohim edhe një ndryshim të karakterit të kryepersonazhit, kapiten Stresit, nga njeri dyshues të variantit legjendarizues në pranues dhe proklamues të tij. Një transformim i befasishëm që në plan të parë të ngjallë habi, duke pasur parasysh faktin se ai ishte ndër të vetmit që dyshonte në atë që thujse tërë njerëzit besonin, madje kishte mundësi që ta mbyllte rastin hetimor në të mirë të tij në çastin kur autoritetet kishtarë dhe ato të principatës e fabrikonjë një kinse të dashur të Doruntinës, i cili ishte i gatshëm që ta merrte përsipër "barren" e kthimit të saj. Por, nëse e lëxojmë vëmendshëm dhe i përcjellim bisedat me miqtë e Konstandinit na jep të kuptojmë se ky ndryshim është i motivueshëm. Nga këto biseda ai del i bindur se besa ka qenë faktor determinues në atë që ka ndodhur. Kapiten Stresi nga një qenie hamendësuese shndërrohet në një individ të mbushur ideologjikisht. Ai në një fjalim publik e shpall "besën" si platformë nacionale dhe si religjion autokton të njerëzve të vendit të tij. Për lexuesin e kohës së sotme, dyshues e hamendësues sikurse Stresi i fillimit të romanit, kjo nuk është zgjidhje e duhur për ta përmbyllur një vepër artistike, por nëse i kemi parasysh rrethanat në të cilat ajo u shkrua, do të thoshim se është përmbyllja më e mirë e mundshme në suazat e asokohshme. Vladimir Propi nënvizonte se *me motivime kihen parasysh si arsyet, ashtu edhe qëllimet e personazheve që i provokojnë në një akt a në një tjetër*[19]. Prandaj, nisur nga ky definim teorik mund të pohojmë se Kadare edhe më këtë rast ka arritur ta ndërtojë dhe ta motivojë karakterin e njërit prej personazheve më të spikatura të krijimtarisë së tij letrare.



Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së poetit

ZEF ZORBA, POETI QË SHKAKTOI HABI ESTETIKE

(Shënime për disa poezi të librit “Buzë të ngrira në gaz”)

nga Yzedin Hima

“Letërsia e penguar” duhet parë si një mozaik, ku çdo pjesë e tij ka të përbashkëtën dhe të veçantën me të tërën. Ky mozaik i çuditshëm u zbulua, u plotësua dorë pas dorë pas vitit '90. Madje, duhet thënë, se ende nuk është zbuluar i plotë, me të gjitha dimensionet. Tekste në dorëshkrim me poezi dhe prozë po zbulohen nëpër arkiva të policisë së fshehtë, nëpër arkiva personale të familjeve, nëpër dosje të ish-shtëpisë botuese të shtetit, si materiale të refuzuara për botim, të gjitha të panjohura më parë. Nuk duhen harruar edhe tekstet e fshehura në kujtesë për arsye që dihen, tekste që po shkruhen aktualisht. Një pjesë e teksteve të botuara pas vitit '90, pjesë domethënëse e këtij mozaiku, u dënuan sërish me harresë, me mungesë të vëmëndjes. Ky është dënim edhe më i rëndë se ai i pari, i burgosjes në sirtare. Rast tipik është botimi i librit poetik të Zef Zorbës “Buzë të ngrira në gaz” në vitin 1994. Botimi i këtij libri duhet të qe një festë e ngjarje e shënuar për letrat shqipe, për shkak të prurjes së pazakontë artistike.

Mosleximi është gjëja më e trishtueshme për një tekst. Më e trishtueshme edhe se djegia e tij në sheshet e qyteteve. Në teorinë e sotme të leximit ka mendime se kuptimi i një teksti gjendet dhe zbulohet

edhe te lexuesi. Përfytyrohet fatkeqësia e teksteve që burgoseshin në kohë, ata humbnin lexuesin, por humbnin edhe një pjesë të kuptimit të tyre që gjendej pikërisht te lexuesi i humbur. Pra ata nuk mund të quheshin kurrsesi të realizuar plotësisht edhe kur të botoheshin pas njëzetë, tridhjetë apo edhe dyzetë vjet pas shkrimit të tyre, kishin humbur një pjesë të lexuesit, i cili kishte ndërruar jetë. Me atë gjeneratë lexuesish kishte “ndërruar jetë” edhe një pjesë e kuptimit të këtyre teksteve. Dihet se një tekst që është shkruar dyzet vjet më parë, nuk lexohet krejt njëllë nga lexuesi i dyzetë vjetëve më pas. Mungesa e lexuesit, sidomos lexuesit të kualifikuar, mungesa e krahasimit të teksteve, konkurimit të tyre dëmton krijimtarinë.

Libri poetik i Zef Zorbës “Buzë të ngrira në gaz”, u botua në vitin 1994, dhe u ribotua i përmirësuar me një parathënie të Ismail Kadaresë në vitin 2010. Ky libër, sikurse njofton autori në parathënie: “Duhet pasur parasysh se në këto pak vargje është shtrydhë e koncentruar një periudhë katërdhjetë-vjeçare”, ka marrë formën e tij në një hark të gjerë kohor. Gjatë dyzetë vjetëve autori dhe lexuesi kanë qenë i njëjti person, Zef Zorba. Pse nuk e botoi Zef Zorba librin e

tij gjatë kohës së diktaturës? Nuk e botoi sepse, falë kulturës dhe eksperiencës së tij, ai e dinte që ky libër ishte i pabotueshëm. Nuk i plotësonte kriteret e vendosura të metodës së realizmit socialist. Poezitë e tij janë hermetike. Këto ishin problemet e tekstit të Zef Zorbës. Por nuk duhet harruar se krahas problemeve që gjendeshin te teksti, kishte mjaft probleme edhe te autori i tij. Zef Zorba ishte një i dënuar politik dhe një status i tillë ishte pengesë e pakapërcyeshme për botim. Mendoj se gjendet edhe një pengesë e tretë, që i pengoi tekstet e tij të botoheshin, kur Zorba qe ende në këtë jetë, pas vitit '90, ndërkohë që dy pengesat e para kishin rënë. Pengesa e botimit të teksteve qe vetë autori i tyre Zef Zorba, i cili, ndonëse kishte mundësi, nuk i botoi tekstet e tij pas vitit '90. Me çduket Zef Zorba ka ndrojtjen dhe pasigurinë e një artisti të vërtetë për artin e tij.

Për këtë poet emblematik të “Letërsisë së penguar” duhet thënë se në tërësinë e teksteve të fshehur në kohë, pati të tillë, që shkaktuan habi estetike, sikurse zbulimi i një margaritari brenda një guacke të thjeshtë, midis një numri të pafund të tillash. Enigma e procesit krijues të Zef Zorbës mbeti përjetësisht e fshehur në kohë, sikurse enigma e krijimit të një margaritari brenda një guacke të mbyllur hermetikisht.

Në tekstet poetike të Zef Zorbës, për vetë tipologjinë e poezisë së tij, takojmë rrjedhoja të dhunës së verbër. “Kur mbetesh vetëm me ty” është titulli i poezisë që ka poshtë shënimin: (Dimër, 1946.) Në këtë kohë poeti dhe gruaja e tij, të dy shumë të rinj, u arrestuan nga diktatura. Vetë teksti i kësaj poezie na vjen në ndihmë nëpërmjet shënitit poshtë titullit për të shpjeguar metamorfozën e njeriut, unit poetik, “në një trupore pjalmi mortore”. Kjo rrjedhë vjen nga gjendja tragjike e subjektit mendues, i prangosur me akuzën “agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”. Ai braktiset nga përditshmëria e jetës së tij, braktiset nga e ardhmja, ndërkohë që pret të dënohet, ai mërgohet edhe nga e shkuara, teksa e braktisin edhe kujtimet. Njeriu shndërrohet në një krijesë pa të djeshme, pa të sotme, pa të nesërme. I vetmi fill që e lidh me jetën është e dashura e tij, gruaja. “Kur mbetesh vetëm me ty, / o zemra ime, / netësh të mbarsura me stuhi, / mërgime kujtesash në atë dhomën e gjatë, / pa dritë. / Në pjesën e dytë të tekstit vizatohet pamja groteske e diktaturës, ndërtesa si grope kumbon nga fabrikimi i fajit, akuzat që do të zënë përfund individin e pambrojtur: Anëmbanë ndërtesa golle se ç’kumbonte / sajimesh / që një mbas një / ndeheshin palë e palë / mbi mua, kapitur gjumi në shpinë / Synimi i diktaturës është i qartë: me më ba dëshirash një trupore pjalmi / mortore. /

Kthimi i njeriut në një vorrezë dëshirash, është metamorfoza më çnjerëzore që mund të ndodhë. Në vijim të teksteve me pamje nga metamorfoza e trishtueshme e njeriut, kemi poezinë me titull “Robër”. Sërish në tekst gjejmë shpjegime të rrafshit kuptimor të këtij teksti pikërisht te shënimin poshtë titullit: (Vjeshtë e v. 1948). Poeti Zef Zorba në këtë ditë ka qenë banor i burgut. Pamja vjen si vizatim i burgut. Njerëzit tani nga qytetarë janë shndërruar në robër në vendin e tyre, nga shteti i tyre. Poezia është eliptike, mjaft sintetike nga ana formale: Epezull varen / në tehun e një rrezeje / qeniet e këputura. / Zef Zorba verteton se gjuha është tinguj dhe fjalë, por është edhe heshtje. Në këtë tekst shohim se njerëzit nuk janë më të tillë, ata janë shndërruar në qenie të këputura. Ata nuk ecin, nuk vrapojnë, nuk vallëzojnë, thjesht qendrojnë pezull, qendrojnë varur. Mund të binin në një gropë a në ndonjë brez ferri, por i mban varur shpresa, e cila është edhe ajo e shndërruar në tehun e një rrezeje. Fjala teh të jep imazhin e presës së thikës ose siç thotë shprehja popullore në presë të briskut. Vetë fjala rreze, si shoqërim idesh na çon te togfjalëshi rreze shprese. Në strofën e dytë të poezisë vizatimi është me ngjyra dhembjeje: Me malle të mënjauara, / me pezme, / stërkalen / me ta këputë shpirtin. / Qeniet janë të zhveshura edhe nga mallet, filli shpirtëror që njeriun e mban të lidhur me të kaluarën me të djeshmen, me të sotmen. Metamorfoza ka prekur jo vetëm trupin e njeriut, por edhe shpirtin e tij, dënimi nuk i është drejtuar vetëm trupit, por më shumë shpirtit



të të dënuarit, sikurse thotë Michel Foucault. Pezmi është aq i madh, sa krijon stërkala dhimbjeje. Shpiti i tyre është shndërruar në dhimbjeje. Diktatura ia ka arritur qëllimit. Ndërsa teksti i poezisë “Zalli i Kirit” sjell një tablo drithëruese, parë në rrafshin estetik, por rrënqethëse, parë në rrafshin semantik. Zalli i Kirit është toponimi në qytetin e Shkodrës që emërton pjesën lindore të këtij qyteti, ku rrjedh lumi Kir. Është i njohur fakti se gjatë viteve të para të diktaturës ky vend përdorej nga shteti për pushkatime me gjyq dhe pa gjyq të kundërshtarëve politikë, apo atyre që konsideroheshin si të tillë.

Në këtë tekst metamorfoza ndodh nga sy fëmijësh në zaje të bardha dhe nga zaje të bardha në yje të zbritur nga qielli. Këto shndërrime ndodhin për shkak të ngjarjes së tmerrshme, vdekjes së fëmijëve në habi. Vetëm ndodhi të përmasave të tilla mund të shkaktojnë metamorfoza. Lëvizja në poezi ka dy sense, njëri i nënkuptuar dhe tjetri i nënvizuar. Lëvizja e parë nënkupton shpirtat e fëmijëve që janë ngjitur në qiell, (pas vdekjes në habi) për vetë natyrën e dliër të shpirtit të fëmijës. Lëvizja e dytë ka të bëjë me sytë e fëmijëve të cilët, pasi janë shndërruar në yje, zbresin poshtë për t'u dhënë dritë zajeve të lumit Kir. Metafora *zallet e bardha pa dritë* dhe pandehma metaforë *mbase janë sytë e fëmijëve*, është mjaft e gjetur. *Sytë e fëmijëve* që vdesin në habi janë të ftohtë si *zallet e lumit*. *Zallet e lumit* janë pa dritë në natë si *sytë e fëmijëve* që vdiqën në habi. Po pse vdiqën në habi? Kjo nuk shpjegohet askund. *Vdekja në habi* tregon se edhe fëmijët që vdiqën nuk e dinin çfarë po ndodhte me ta, pse po vdisnin. *Zallet e lumit*, në një farë mënyre, kur lumi shterr, duken si eshtrat e lumit që ka vdekur. Ky tekst vetëm me shtatë vargje të krijon dhe të jep mundësi të krijosh si lexues imazhe të panumërta. Natyrisht, kjo është veti e teksteve letrare të arrira sikurse ky: *Zallet e bardha pa dritë / ku natën zbresin yje / me mijëra / pa u ndi. / Mbase janë sytë, / sytë e fëmijëve / që vdiqën në habi. / Kur e lexon këtë tekst vëren se asocacionet semantike vihen në lëvizje nga asocacione formale të ngjyrës, tigujeve, ritmeve.*

Te tekstet poetike të Zef Zorbës fëmijëria është shenjues i kohës tjetër, në kontrast me antikohën që jeton uni poetik në moshë të rritur, ku qytetërimi është kthyer mjaft pas, në mug të tij, në barbari. Teksti i poezisë “Sa mirë, atëherë...” ndërtohet në dy pjesë: fëmijëria dhe moshë e rritur. Nostalgjia për fëmijërinë nuk është nostalgjia universale, që gjithkush në një moshë të rritur ka për kohën kur ishte fëmijë, por është nostalgji për kohën kur ishte i lirë: *Sa mirë, atëherë, o mite, kur isha fëmi; / I lodhur prej lodrimesh gjithë ditën, / nën hije të një shelgu bija këputur gjumi: / ëndrra / gjithfarë plot ndriçime./*

Uni poetik u drejtohet miteve, me të cilat qe mëkuar fëmijëria e tij. Fëmija ëndërron të ardhmen e vet të lumtur, e cila nuk që e tillë për shkaqe që dihen. Në antikohë mitet treten, personazhet mitologjik strehohen në mitet e tyre, sepse krijohen mite të rinj. Në pjesën e dytë të tekstit kemi një metamorfozë tërësore: dita kthehet në natë lubi, shpirti përkundet ndër helme, arsyeja brehet e bren, pra shndërrohet në mi. Uni poetik ndjek rrugën e Jezu Krishtit për në Kalvar, vend i mundimeve dhe sakrificave të padrejta. Në tekst dallojmë refuzimin e kohës se tashme dhe strehimin në kohën e shkuar. Jeta e unit poetik shndërrohet thjesht në “*gjurmë të thella në baltë*”. Siç kemi shënuar edhe më herët, kjo metamorfozë ndodh për shkak të vendosjes së diktaturës, e cila i ktheu njerëzit e formuar në të dënuar me punë të detyruar dhe të keqpaguar, jashtë formimit dhe profesionit të tyre: *I pezmatuar / tash vetëm ndrydhi, e nata, e ditës lubi, shpirtin ndër helme përkundë, / e arsyeja brehet/ pa nda, e bren. / ...bie ora pesë: unë kryqin marr në krah / e me pak frymë fillohem për Kalvar. /*

Edhe më e rëndë është pamja që sjell një tjetër tekst poetik i Zef Zorbës i titulluar “Kesh ngopeshim me frymë”. Shënimi poshtë titullit (1948) na vjen në ndihmë për të kuptuar se pamja nuk vjen nga ferri, por nga burgu. Në këtë kohë poeti ka qënë duke kryer dënimin si i burgosur politik. Edhe në këtë tekst, për arsye që tashmë dihen, kemi metamorfoza të tilla: qielli është kthyer në plumb dhe u peshon mbi supe të dënuarve, njerëzit janë kthyer në skelete, horizonti lidhet nyje, shtegu i horizontit kyçet, mendimi mbet aty në horizontin e mbyllur dhe kthehet në një pikë, nofullat e dërrmuara përtpin mundimin. Të gjitha dëshirat njerëzore të unit poetik janë shndërruar e zvogëluar në ekstremin e tyre: *...kesh ngopeshim thellë / njëherë me frymë. / Është një nga tekstet poetikë që sjell një realitet artistik jo të zakonit, parë në të gjithë “Letërsinë e penguar”:* *Mbi supe të kanalit, / jarguar currilash, / plumb një rryp qielli / peshon. / Në vargjet që vijojnë vizatohet një pamje që ndeshet në kohën e skllëverve ose në kampet naziste: *Shikonani: / vërtetojmë burime primitive: / me nofulla kërcëlyese / të dërmishuara, / përtpim mundim / e balta e në unji. /**

Zef Zorba e provoi vetë këtë ferr dhe, falë mjeshtërisë së tij, lexuesi gati e ndjen edhe mbi supet e tij qiellin që rrëzohet si plumb mbi supe. Zef Zorba me artin e tij realizon atë që beson kur shkruan në pasthënien e librit “Buzë të ngrira në gaz”: “*Lexuesit i kërkohet përgatitje shpirtërore, kulturore dhe artistike për ta bërë bashkëautor me artistin, jo vetëm për të interpretuar atë që i komunikohet, por për ta ndjerë e për ta vuajtur bashkë me poetin.*”

Në këtë tekst nuk shohim asnjë rreze shprese, sikurse shohim në tekstet e tjerë të Zef Zorbës me pamje burgu. Kur horizontet lidhen nyjë, atëherë edhe mendimi është i burgosur, bie në pranga, shpresa vdes dhe qeniet kanë vetëm një dëshira te vetja, të ngopen me frymë: *Atje, përpara, larg, në mugëtirë, / ku vija paralele lidhen nyje / dhe e kyçin atë shteg të vetëm që mbeti, / atje mendimi ndalet pikë: kesh ngopeshim thellë / njëherë me frymë. /*

Në tekstet poetikë të Zef Zorbës, krahas *grisë* dhe *të zezës* nuk mungon *e bardha* plot dritë. Diktaturat janë të përkohshme me terrin dhe terrorin e tyre, ndërsa e përhershme është drita. Poema “Baladë dritash për Lalin” e Zef Zorbës mbyllet me vargun “*Veç drita s'ka mbarim*”.

IN MEMORIAM GIUSEPPE GRADILONE

nga Prof. dr. Valter MEMISHA

Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë

Të nderuar studiues, albanologë dhe miqtë mi,

Me hidhërim mësuam për ndarjen nga jeta të prof. Giuseppe Gradilone-s, studiuesit të përkushtuar të gjuhës shqipe e të letërsisë arbëreshe e shqiptare bashkëkohore.

Prof. Gradilone u diplomua në Universitetin e Studimeve “La Sapienza” të Romës për Letërsi Klasike, duke u specializuar në Filologji Klasike dhe më pas kaloi në fushën e albanistikës. Pas vdekjes së Prof. Ernest Koliqit u ftua si profesor ordinar për të dhënë lëndën e letërsisë dhe gjuhës shqipe po në këtë universitet, duke futur për herë të parë në Itali edhe lëndën e Filologjisë shqipe. Ai qe drejtor edhe i Institutit të Studimeve Shqiptare pranë Universitetit “La Sapienza”-s. Punoi me përkushtim edhe si redaktor i revistës “Shëjzat” ku botoi shumë nga artikujt e tij. Analizave të krijimtarisë letrare të shumë autorëve, si De Rada, Santori, Serembe, Fishta, Frashëri, Schirò etj., u kushtoi disa vepra, ndër të cilat mund të përmendim: “Virgilio e Naim Frashëri”, 1957; “Salvatore Braile, poeta albanese”, 1958; “Studi di letteratura albanese”, Roma, Urbinati, 1960; “Altri studi di letteratura albanese”, Roma, Bulzoni, 1974; “La letteratura albanese e il mondo classico”, Roma, 1983; “Studi di letteratura albanese contemporanea”, Istituto di Studi Albanesi dell’ Università degli Studi di Roma “La Sapienza”, 1992.


Me shumë rëndësi janë edhe kontributet plot akribi të prof. Gradilones në fushën e botimeve kritike të veprave të botuara apo të mbetura dorëshkrim të autorëve arbëreshë ku përmendim: Girolamo De Rada, “I canti di Milosao”, Roma, 1965; “Zonjës madhe perëndeshë Elenës Gjika (Canto a Dora d’Istria)”, Roma, 1986; “Contributo alla critica del testo dei canti di Giuseppe Serembe”, Roma, 1989; Francesco A. Santori, “Panaini e Dellja - Fëmija pushtjerote”, Roma 1989.

Pjesë e kërkimit të tij shkencor ka qënë edhe studimi dhe botimi i letërsisë së transmetuar gojariht deri në ditët tona nga komunitetet arbëreshe në Itali.

Me shuarjen e prof. Giuseppe Gradilone-s, komuniteti i albanologëve humbi një nga anëtarët e tij të shquar dhe letërsia arbëreshe e shqipe hulumtuesin e pasionuar.

Në emër të kolegëve të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë u shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të tij.

Qoftë i paharruar kujtimi i prof. Giuseppe Gradilone-s!



STEFAN ÇAPALIKU

Virusi më përndjekë, por unë jam ma i shpejtë.

-nga ditari i Martin Cukut-

vijon nga numri i kaluar

18. Duke më dhanë pretencën gjykatësi italian më tha me za të naltë, se gjatë këtyne ditëve shtesë, as nuk duhej ta çoja nëpër mend se ekziston coronavirusi. Nëse e çon nëpër mend, tha ai, nuk duhet ta za në gojë me askënd. Dhe mandej nëse e çoja nëpër mend dhe e zija në gojë, të mos ia shkruja emnin askund. Dhe në përfundim e si konkluzion, nëse e çoja nëpër mend, e zija në gojë dhe ia shkruja emnin, atëherë duhej t'i laja mirë durt para ngrannies!

19. "Tash që mora dënimin po më duket se jam ba pa u qethë. Nuk di si me ia ba. Flokët e gjatë nuk më kanë shku kurrë. Këtu në Cinquantina punën e berberit e ban një italian që ka pasë drejtu një autokombanjë. Merr 20 euro për qethje. Po ia ha dreqi shpirtin, se po i jap unë 20 euro! Ma mirë qethem vetë. Do shkoj e të marr zdrukthin që mban në dorë skulptura e Sh'Jozefit te kisha."

20. 12 Mars 2020. Që mbramë na kanë braktisë rojet. Natyrisht që s'ka ma kuptim që dikush të rujë kufinin midis fshatit Cianquantina me Trentina, kur të gjithë jemi përfshirë në zonën e kuqe. Nuk di ma ku të shkoj. As unë nuk di ku të shkoj, erdhi e më tha ai roja arbëresh. Çfarë t'i thoj. Thjesht i dhashë të lexonte "Kanga e sprasme e Balës" e Gavril Dara i Riu".

21. "Natë. Dëgjoja kërcitje të lehta te xhami, si të ishin bremje miu. Hapa me kujdes dritaren dhe gjeta mbatanë një person që pëshpëriste emnin tem. Një person që kishte ardhë të më kontaktonte fshehurazi. Ishte një tip nga ambasada shqiptare në Romë. Ai më lëshoi një pusull në dorë. Kujdes, më tha, asht një listë me disa këshilla nga ministrja e kulturës që tregon se çfarë filmash shqiptarë asht e mira të shohësh këtu në Cinquantina. Sa mirë, mendova, që shteti im në një formë a një tjetër nuk më len vetëm. Nuk më braktis. E hapa gjithë lezet. Në krye të listës kishin vendosë filmin "Nusja dhe shtetrrëthimi!"

22. "Të nesërmen unë me Abdelkabinin pamë deri mbas mesnate filmin "Përballimi". Ky ishte filmi i dytë në listen e rekomandimeve të ministres së kulturës. U mendova boll t'ia perktheja Abdelkabitit, por nuk qe e lehtë. Atij i pelqenin me shumë aktorët. Ju shqiptarët, më tha, keni aktorë të nivelit botnor. Faleminderit shumë, ia ktheva krenar. Ejvallah!"

23. "Andej nga mjesi, së bashku me Abdelkabinin dhe me ish rojen arbëresh, bamë gati dy dengje me rroba të vjetra me i nisë për Shqipëri. Vjen i merr dikush që i shet në Tiranë, andej nga Shkolla e Baletit. Se çfarë lidhje ka baleti me këtë biznes nuk e di, por me rëndësi asht që Abdelkabiri më siguroi, që zonjat në Tiranë mund t'i prekin pa merak, se janë të painfektume"

24. "Dhe meqë ra fjala te infeksioni, kam dyshime se ajo kongolezja asht infektu randë. Kështu mendonte edhe Abdelkabiri. Pse? E pyeta una, ka temperaturë, ka dhimbje fyti? Jo mor jo, por ka fillu me folë pak si mirë italisht, më tha ai. S'di pse Abdelkabiri e ka këtë përshtypje se coronavirusi ka edhe anë të mira. Të ndriçon mendjen, përshembull"

25. "Ne shqiptarëve të ngujum këtu në Itali na erdhi edhe një udhëzim tjetër nga ambasada jonë në Romë. Duhet të dalim nga Cinquantina dhe të deklarojmë të ardhurat tona. S'kam ç'të bëj. Prej respektit që kam për shtetin tim u nisa të dal ilegalisht dhe të shkoj te të gjitha bankat e katundit, për të vertetu se nuk kam asnjë lek dhe asnjë kokërr euro. E di se do më kapin që te banka e parë, por nuk kam çfarë të baj. Më mirë të më kapin duke kry detyrën para shtetit tim, sesa para një shteti tjetër. Se kush e duron mandej nofkën spijun"

26. "Mbramë mbas mesnate, gjatë kohës që me Abdelkabinin dhe atë kongolezen, Aminatën, po shihnim filmin "Nusja dhe shtetrrëthimi", ra dera. Ishin disa dëshmitarë të Jehovait. Hej more drej, nuk na u hiqnin qafe pa na lexu me za të naltë fragmente nga libri "Te udhëtosh nga kjo botë për botën tjetër, sa e lehtë dhe e bukur!"

27. "Sot në mëngjes më erdhi prapë një radiogramë. Kësaj radhe ishte nga Ministria e Arsimit e shtetit amë. I dashtun zoti Martin Cuku, shkruhej në të, meqënëse këndeje e mbrapa mësimi do zhvillohet online, a keni ju ndonjë pyetje për zonjën ministre? Tani, t'i thoj se unë ka kohë që i kam la durt me shkollën dhe se nuk kam as fëmijë për shkollë, më erdhi si turp, prandaj i thashë vetes, bëja edhe ti një pyetje s'e s'u ba nami, ndoshta i hyn në punë. Dhe aty për aty i nisa zonjës ministre pyetjen, si më poshtë

vijon: Zonja Ministre a asht mbyllë shkolla vetëm për nxansit apo edhe për msusit?"

28. "15 Mars 2020. Nuk rrihet ma këtu. Jena ba derr. Aminata, Imrani me Harunin, Calixto, Beatriz dhe Caridad, me mu në kry dhe Abdelkabinin jemi betu dhe i kemi dhanë besën njeni-tjetrit, natyrisht pa shtërngime dursh, se do t'ia mbathim nga Cinquantina. E dimë se rruga do jetë e gjatë, e vështirë dhe do ketë shumë të paprituna, por me randësi asht që ne do ikim. E ç'punë kemi ne me virusin Italian? E aq ma pak kinez.... Jo, kjo s'asht e drejtë".

29. "Me dy fjalë ideja kryesore është të hyjmë ilegalisht në Shqipri. Imrani me Harunin androjnë të hapin një furrë buke; Calixto, Beatriz dhe Caridad dëshrojnë të rihapin ambasadën kubane në Shqipri, të mbyllun mbas, gjoja, rrezimit të komunizmit; Aminata pandeh se do mund të kërcej për një klub nate, sapo të shërohet nga coronavirusi, kurse unë me Abdelkabinin dum të celim një shkollë për bletrritës. Lutuni për ne!"

30. "U nisëm dhe kemi ecë gjithë natën. Ec rrugë pa rrugë dhe ban kujdes nga policia. Ka ardhë me ne edhe prifti, don Tarcisio. Gjithmonë kam dashtë të jem misionar në Shqipri, më tha. Don Tarcisio ka një busull me të cilën po orientohe mi. Diku mbas 10 km rrugë vumë re një hije që po na afrohej. Fillimisht u trembëm, mandej vumë re se ishte një femën bionde dhe u qetësum. Nga po shkoni, pyeti ajo. Hiç, kemi dalë për qejf, ia priti Don Tarcisio. A do vish edhe ti me ne, u hodh dhe pyeti Abdelkabiri. Jo, tha ajo, kam frikë, se sa herë që dal për qejf mbes shtatzanë. S'e ku e kisha pa atë fëtyrë."

31. "Kemi vendosë të marshojmë nga 40 km në ditë, por qenka punë që s'bahet, aq më tepër kur je në grup. Imrani me Harunin janë dembelë të mëdhenj, kështuqë na duhet edhe ne të tjerëve të mbajmë ritmin e tyre. Nga ana tjetër asht e nevojshme të rrimë sa ma pranë njëni-tjetrit dhe të mos shpërndahemi, për shkak që të mos biem në sy të policisë. Pra, nga njëra anë dum të ikim nga Cinquantina për arësye të quarantinës, dhe nga ana tjetër nuk arrijmë të respektojmë asnjë rregull kundër virusit".

32. "Në kilometrin e gjashtë ka plasë sherri midis fjalës për Che Guevarën. Calixto, si marksist i thekun, e çon në qiell, kurse Don Tarcisio thotë se ai ka qenë një mut muti. Tashti unë, me atë italishten time, nuk e di tamam sesi e shanë Don Tarcisio Che-në, por më tingëllon si diçka e tillë. Tamam mut muti ose shkërllatë."

33. "Sipas Don Tarcisios, që ka jo vetëm busull, por edhe internet, dje kemi arritë të ecim vetëm 28 km. Ai thotë se jemi shumë larg objektivit. Por ne nga ana tjetër vumë re se na kanë ndodhë dy gjana: jemi të gjithë të bllokum muskujsh, përvec Don Tarcisios që ka qenë skautist, dhe e dyta dhe ma e çuditshmja asht se kemi pa të gjithë të njajtën andërr: sikur një lakuriq nate qenka sjellë gjithë darkën mbi kokat tona, duke na pëshpëritë te veshi që të mos shkojmë në Shqipri, se gjoja atje gjendja do rëndohet edhe më shumë se këtu në Itali".

34. "U nisëm mbasdite vonë, mbasiqë Don Tarcisio na bani masazhe kambëve të të gjithëve. Fillimisht Beatriz dhe Caridad nuk pranun medemek se kishin marre, mirëpo në fund dolën të dyja duke fluturu prej lezeti. Ec e mbaji tani. Calixto vazhdon ta mbajë inatin e ngatresës me priftin. Ai pothuajse asht mbyllë krejt më vete. Ecën duke lexu një manual të luftës gurrale, të hartum nga vetë Fidel Castro. Dy binjakët nga Bosnja flasin në gjuhën e tyre diçka që ka lidhje me tezat globaliste të Alija Izetbegovic. Veç unë me Aminatën dhe Abdelkabinin nuk flasim kur ecim. Nuk



flasim ngaqë asnjë prej nesh nuk di italisht. Mbetemi me shpresë se diçka do mësojmë gjatë rrugës.”

35. “E ndjeja se në një farë mënyre të gjithë më pyesnin dhe donin që t’i tregoja diçka për atdheun tim, pra për vendin për ku ishim nisë. E kisha të vështirë, shumë të vështirë t’ia thoja në italisht, megjithatë u shtërngova dhe diçka belbëzova, të tipit: “Il mio posto è molto bello. È pieno di montanari, mari, laghi e paludi. Ha anche pochissimi terreni agricoli verde. Il mio posto ha brave persone. Ci sono anche le persone che lavorano molto bene e lavorano sodo. Tutti sono dei padroni di casa eccezionali.”

36. “Abdelkabiri mban me vete një fotografi të Immacolatës dhe çdo 1.5 km ndalet dhe vajton. Në një përlogaritje të shpejtë që kam ba i takon që dje, përgjatë 28 km që kemi përshku, Abdelkabiri të jetë ndalë për të qarë vetëm 14 herë. Unë mendoj se asht shumë të qashë 14 herë për Immacolatën. Ai duhet ta rikonsiderojë këtë çështje. Do Zoti dhe sot do qajë më pak.”

37. “Frikë e madhe se mos na kapnin sepse na u desh të kalonim mospërmas një qyteze të vogël, ngaqë s’kishte shteg tjetër. Për fatin tonë askush në rrugë, madje as policia. Mu kujtu Shkodra në kohën e komunizmit, darkën e ndeshjes finale Itali-Gjermani më 1982. Por jo sivjet do ketë olimpiadë e jo kampionat botnor futbollit.”

38. “Jemi shtri të gjithë ndën strehën e një stalle të braktisun. Secili në çantën e vet të shpinës mban nga një tapet, që në kushte normale shërben për joga a diçka tjetër. Veç dy binjakët nga Bosnja kanë një. Ata flejne si fanti spathi. Aty ku vë kokën njeni, mbështet kambët tjetri. Jastëk ka vetëm Don Tarcisio. Asht jastëk gome, që Abdelkabiri ia fryn përnatë, në shenj respekti.”

39. Mu më janë ba çorapet pa u la. Dy gjana nuk kam ditë me ba në jetë: me la enë dhe tesha. I them Animatës, por ajo refuzon. Aq premë më refuzon sa kam idenë se ajo asht e bindun se koronavirusi fshihet tek unë. Diku në trupin tim. Në mos te çorapet, diku tjetër. Kaq është e fiksume pas kësaj, sa jam i frikësuar se mos çohet ndonjë natë tinzash dhe më heqë qafe...”

40. “Abdelkabiri ka qilimin e faljes. Po të mos ishte me ne Don Tarcisio që ka busull, ai kurrë nuk mund ta gjente drejtimin e Kiblës dhe kushedi se

nga cila anë do ta kish drejtu qilimin e faljeve. Ai falë sabahun, dreken, ikindinë, akshamin dhe jacianë. Pra 14 herë qan për Immacolatën dhe 5 herë falet. Kjo e bën Abdelkabinin një person shumë të dashtun për të gjithë ne”.

41. “Sot në mjes më kanë ça bythën të gjithë me radhë, duke u anku se gërhas shumë natën. Je i padurushëm, e nisën të parët shamatën binjakët nga Bosnja. Po të kishim pasë burrë do të të kishim ndarë në vend, u hodhën e thanë Beatriz dhe Caridadën. Ju skeni pse më ndani, u thashë, mjafton të më ktheni nga ana tjetër dhe unë pushoj. E të plasi një rrotë shërri prej kësaj që fola. Dashke edhe të të prekim! Ti s’je në vete! E të tjera si këto. Vetëm Aminata nuk fliste. Ia dalloja urrjetjen te të bardhat e syve.”

42. “Tema e gërhitjes u trajtu edhe gjatë rrugës që kalonte nëpër një pyll gështenjash, që sipas Don Tarcisios të çon në anën tjetër të lumit “Jo”. Mund ta vazhdonin edhe më gjatë këtë bisedë, nëse s’do na kishte dalë përpara një rojtar pyjesh, i armatosur me një çifte. U ngrimë në vend. Nëse nuk doni t’ju shkep me gjoba për shkelle të rregullores së sjelljes ndër zona të pyllëzume, më merrni me vete, urdhnoi ai. Më qujnë Giacinto, për shkurt Cinto. Jam edhe kuzhinier. Mund të hapi një restorant të vogël në Shqipri. Me që ra fjala te restoranti, qe ku po ju them se mu më ka këputë malli për groshë”.

43. 18 Mars 2020. Me ardhjen e Cintos u bamë fiks dhjetë vetë në grup: Imrani me Harunin, Aminata, Calixto, Beatriz dhe Caridad, Abdelkabiri, Unë, Don Tarcisio dhe Cinto. Na mungon edhe një për t’u ba një ekip futbollit. Apo edhe s’jemi mirë me kambët mbas gjithë kësaj ecje. Unë çasht e verteta jam mësu me ecë kur isha në katund. Gjithmonë më çonte baba me një thes kallomoq në shpinë me shku e me e blu te mullini. Por kësaj radhe puna asht ngusht. Ma mirë me një thes në shpinë sesa me dhimbje fyti e temperaturë...”

44. “Arsyja e vertetë se pse Giacinto iu bashku grupit na qenka se ai, si rojtar pyjesh, na paska grabitë gjatë natës një farmaci dhe e kishte kapw frika. Ka mbushë një cantë me maska dhe me vitamina c. Tesh kemi maska sa me fshi bythen me ta. Ndërkaq të gjithë morën nga dy vitamina c. Unë shkova e piva katër. E më kanë hapë një oreks, që jam ba gati me i hangër të dy binjakët boshnjakë me një kafshatë...”

45. “E shoh se Imrani me Harunin janë lodhë. Ata nuk janë për sporte rezistence. Një lojë

shahu po, atë do ta kishin përballu që ç’ke me të. Dhe doli tamam ashtu si thashë unë. Ata u shtrinë në breg të lumit “Jo” dhe thëritën me të madhe policinë, që të vinte e t’i merrte e t’i çonte edhe njëherë në karantinë. Në një karantinë dosido, qoftë edhe në Cinquantina. E shkreta polici italiane. Kështu që mbetem tetë...”

46. “A ke lajme nga Shqipria? Më pyeti Don Tarcisio, sot në muzgun e 20 Marsit 2020. Asnjë lajm, i thashë. Unë nuk kam internet. Atëhere Don Tarcisio filloi të rremonte diçka te celulari i vet dhe u kthye prapë nga unë: Cilin portal mendon se duhet të shikojmë për situatën në Shqipëri? Kush është më i besushmi? Ai i Akademisë Ushtarake Skenderbeu, ma merr mendja, i thashë”.

47. “Sipas gjasave ka shumë mundësi që e kemi kalu prej kohësh një farë vendi që thirret Pescara. Aminata dhe Caridad patën një farë të përqethune në shtat kur ia shpjegova se çka donte me thanë kjo fjalë në gjuhën time amtare. Hoqa dreqin me ia shpjegu. Të dyja harronin shumë shpejt. Sa arrin robi te fjala e tretë ata harronin të parën e kështuqë duhej me ia nisë prej fillimi...”

48. “Më janë ajntë shumë variçet. Prej të ecunit. Jo, jo, prej të ecunit, por prej koronavirusit, më tha Aminata. Mirë të bahet, shtoi ajo. S’po e marr vesh nga e ka gjithë këtë inat me mu kjo femën. A ka ba vaki me t’u ajntë e me t’u eksitu variçet prej koronavirusit?! Këto nuk don me të lanë me vdekë prej asnjë arsye tjetër, përveç koronavirusit”.

49. “Giacinto ka qenë alpin. Ai ecën më shpejt se Don Tarcisio dhe i di mirë shtigjet. I njeh shumë mirë edhe kërpudhat. Ai ka një nuhatje të jashtzakonshme edhe për tartuf. Unë nuk e di se cka asht ky tartufi, por i pashë sesi ata të dy e rendonin mbi makarona tinzash nesh. Po na e bajnë me hile. Abdelkabiri me Animatën janë miqsu shumë. Ata seç gatujnë në hesapin e vet, kurse ata kubanët jetojnë veç me kallama sheqeri dhe rum. Unë mbarova për groshë”.

50. “I është mbushë mendja të gjithëve që, gjatë kohës që ecim deri në Otranto, të mësojnë shqip dhe më janë lutur që të hapi një kurs. Unë hapa dy kurse. Në të parin kam futur Abdelkabinin, Calixton, Beatriz dhe Caridadën. Kurse në grupin e dytë janë: Don Tarcisio, Giacinto dhe Aminata. Dhe meqënëse i duhet ta mësojnë gjuhën shumë shpejt kam mendu që t’ia nis mësimin e shqipes me disa fjalëshpejta. Fjalëshpejta e parë për të dy grupet është: Në karantinë karikaturisti karikaturon një karikaturë karakteristike”

51. “Calixto, si marksist i çmendun që asht ka një teori të veten për këtë që po ndodhë. Ai thotë se ky është një plan i fshehtë i borgjezisë ndërkombëtare për të shu zjarrin poshtë kazanit të madh proletar, që na paska pas mbërritë pikën e vlimit. Dhe me italishten e tij e reciton me vete kësaj: “Questo è un piano segreto della borghesia internazionale per estinguere il fuoco sotto il grande calderone proletario che ha appena raggiunto il suo punto di ebollizione”. Mbas dëgjova për të njëmbëdhjetën here deklaratat e Calixto i thashë Abdelkabirit se jJam ma se i sigurtë se, nëse kjo historia ka me pasë fund, atëhere në finale, do të rezultojnë ma shumë të çmendun se të infektum,”

52. Aminata na paska pa andërr, kur ka qenë duke ecë, se po more tetë thelpinj hudra dhe i vlojmë në shtatë gota uji dhe i pijmë me gjithë hudra atëhere koronavirusi pirdhet prej nesh, si të mos kishte qenë. Për ty duhen tridhjet e dy thelpinj, më tha mu. Hajde të dalim tashti nëpër bahce e të mbledhim hudra?! Jam i sigurtë që do na kapë policia. Mandej, nga ana tjetër, ba me hangër tridhjet e dy thelpinj hudra, kam frikë se vdes.

(Vijon në numrin e ardhshëm)
/©/stefan /çapaliku/tiranë/mars/2020/

Sa here kthehem nga shkolla, nuk hyj në shtëpi. Pres pak në oborr. Dëgjoj. Nëse ata janë brenda, kthehem e hyj në shtëpizën e oborrit dhe i lë të mbarojnë. Grindjet e tyre marrin fund zakonisht me të shara. Tata del duke shfryrë. Mama qan.

Nganjëherë ai nuk është në shtëpi dhe unë mundem të hyj menjëherë. Shkoj me vrap te mama. Raste të tilla ndodhin rrallë, duhet me shfrytëzuar cdo sekondë. Mama gëzohet dhe më pyet për shkollën, unë përgjigjem e i ulem në prehër. Kur vjen ai unë thërras me të madhe Tatë dhe nisem drejt tij. Nganjëherë më përfaqon. Nganjëherë ma kthen shpinën dhe hyn në tjetër dhomë. Sidoqoftë atë ditë s'ka grindje. Por si thashë, kjo ndodh rrallë. Ai është në shtëpi më shpesh tash, se nuk ka punë. Dhe mësuesi im budalla nuk më lëshon të ik nga shkolla më herët. S'është e mundur që të dhemb barku përditë, thotë ai. Nuk bën me shku. Por mua barku më dhemb vërtet. Përditë.

Nganjëherë në shtëpi është vetëm ai dhe mama ka dalë. Një ditë kur hyra thirra Mamë, mamë, se kujtova se ajo është në shtëpi. U preva për një moment kur e pashë atë, tek më kundronte ngultas. Ai vetëm mbylli derën e dhomës. Unë prita në kuzhinë derisa erdhi mama, bëra detyrat e shtëpisë. Ishte qetë. Unë harroj shpesh të bëj detyra të shtëpisë, jam budallaqë, harroj harroj, por atë ditë shqyr më ra ndërmend. Të nesërmen mësuesi më lavdëroi, kisha shkruar mirë. Është mirë kur dikush të lavdëron. Por zakonisht mësuesi më qorton, pse harroj harroj. Unë jam harraja më e keqe në botë. Një tjetër ditë ai ishte vetëm prapë dhe m'u duk se po qante. Kish zënë kryet me duar dhe fshantë, përqyrr. Qante, më duket. Nuk jam e sigurt, mamën e kam parë shpesh tek qan por atë kurrë jo. Por më duket se atë ditë qante.

Unë iu afrova, desha ta ngushëlloj. Nuk e bëj më. Ai më shtyu dorën, e brofi në këmbë. Deren e përplasi me ushtimë. Nuk di se çfarë kisha bërë keq. Nganjëherë më duket se ai nuk më do. Goxha shpesh, në fakt. Mamën nganjëherë e do, qesh me të. Rrallë vërtet, por ndodh. Edhe shokët e vet i do, ata që vinë nganjëherë në shtëpi ta marrin. Qesh edhe me ta, duke dalë. Me mua jo. Ai nuk më do më.

Dikur më donte. Kur isha më e vogël, në klasë të parë, të dytë, të tretë, të katërt, ai cmendej mbas meje. Më conte vetë në shkollë, nganjëherë sipër supesh. Më kujtohet si dukej bota nga ajo lart, ishte aq qejf. Ai më pyeste se ca shoh atje lart dhe unë përgjigjesha, sistemin diellor. Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani, Neptuni. Dhe ai më thonte që unë jam vajzë nga Jupiteri, pse kam lindur në shenjë të Shigjetarit dhe aty vendos Jupiteri. Qeshnim shumë. Kur mbaroja shkollën, ai më priste te porta me akullore. Jo gjithmonë pra, e di që nuk mund të ketë patur akullore gjithmonë. Por mua ashtu më kujtohet. I qeshur në diell, me akullore në dorë. Eja pra, vajzë nga Jupiteri. Oh tatë.

Nuk e di pse prekem gjithmonë kaq fort, jam budallaqë budallaqë. Kjo ka ndodhur moti. Atëhere kur ai dhe mama ishin mirë. Kur dilnin nganjëherë në mbrëmje dhe ktheheshin të qeshur. Për mua kujdesej gjyshja. Ajo ka vdekur. Oh gjyshe. Nuk di pse prekem kaq fort. Budallaqë budallaqë.

Por pastaj ndodhi dicka. Nuk di se kur nisi, se nisi gradualisht, jo bam përnjëherë. Gotat e qelqurinat tjera thyhen bam përnjëherë. E di, se kam thyer vetë disa. Njerëzve u merr kohë. Ndoshta ishte faji i mamës, ajo nisi e para. Grindjet e para që mbaj mend është mama ajo që bërtet. Ankohet se bën dy punë, se i ka rënë shtëpia mbi krye. Ai ia kthen shkurt, me zë të ulët. Atyre herave të para mbaronin grindjet me pajtim. Uleshin rreth meje. Ishte pak i frikshëm, ai ndryshim, por e di se e bënin për mua. Atëhere unë kisha një si fuqi magjike. Isha vajza nga Jupiteri.

Ti ndoshta nuk di për planetin tim, se njerëzit dinë vetëm shenjat e mëdha të zodiakut. Por ato



VAJZA NGA JUPITERI

tregim nga

Shqiptar Oseku



sundohen nga planete mbas tyre. Jupiteri sundon mbi Shigjetarin, nga 23 nëntor gjer më 21 dhjetor. E unë kam lindur më 11 dhjetor, që i bie mu në mes të periudhës; më Jupiter se unë nuk gjen. E pra Jupiteri është planet i plotnisë, i tolerancës, e urtësisë. Jam ngazëllyer kur kam parë sa shumë flasin për Jupiterin astrologët në internet. Është sundimtar i mirënjohjes, shpresës, fatmirësisë, e mëshirës, për të përmendur vetëm disa. Jupiteri ishte kryezot i romakëve, na ka thënë mësuesi. Atij nuk i pëlqen astrologjia. E quan pseudoshkencë, e thotë se s'ka dëshmi për saktësinë e saj. Më kujtohet që dikur i thoja, me pamje prej shenjtojeje, se dëshmia jam unë.

Por më vonë fuqia ime magjike shteroi. Budallaqë budallaqë. Isha në klasë të pestë dhe kishim nisur të mësojmë për historinë antike dhe për shkencën dhe për Giordano Brunon dhe mua m'u dhimbs ai. Unë deklarova solemnisht në klasë, duke parë mësuesin në sy me seriozitet, se më s'besoj në zotëra të shpikur e në astrologji. Mësuesi u gëzua shumë, ishte ndjenjë e mirë. Por Jupiteri u zemërua. Budallaqë budallaqë.

Aty e tutje punët morën teposhtëzën. Tata humbi punën. Ai punonte në një ojqë, nuk di ca është kjo por është dicka ku u ndihmojnë njerëzve. Por atij vetë nuk i ndihmoi ojqë, nuk di pse. Jupiteri. Dhe tash që ai është në shtëpi nuk kemi më pare. Mama ka marrë edhe një tjetër punë dhe grindet shumë me tatën. Thotë se ka tri punë, se i ka rënë shtëpia mbi krye. Një natë tata humbi torruan. Kurvë, ti deshe të kishe fëmijë jo unë, tha. Mama u step. U ndala edhe unë, tek po vizatoja në dhomë të ditës. Tata u ndal poashtu. Më këqyri një herë. Pastaj doli, duke përplasë derën me rraptimë.

Mama nisi të qajë. Zakonisht unë e ngushëlloja. Por atë natë nuk m'u dha.

Jupiteri.

Unë jam budallaqë budallaqë. Gjithcka është faji im. Ikën pranvera, vera, vjeshta, dimri, e Jupiteri vazhdoi të hakmirret ndaj meje. Kam këqyrë me kujdes në internet dhe Jupiteri ka edhe anë të errëta. Zemëratën, tekat, teprimet. Mizorinë. Tashti është prapë pranverë dhe një infektim është përhapur në botë, virusi korona. Njerëzit vdesin si mizat. Tata rri tashti më shumë në shtëpi, por kjo nuk është mirë se ai dhe mama grinden përnatë. Është thuase Jupiteri më hakmirret duke goditur gjithë ata që janë afër meje. Gjyshen e ngratë, që vdiq nga korona. Oh gjyshe. Tatën që ulërin. Oh tatë. Mamën që qan, oh mama jeme.

Budallaqë budallaqë, gjithcka është faji im. Dikur grindjet mbarnin me pajtim se unë isha vajza e Jupiterit. Uleshin rreth meje, qetësoheshin. Ishte pak i frikshëm, ai ndryshim, por e di se e bënin për mua. Atëhere unë kisha një si fuqi magjike. Isha vajza nga Jupiteri.

Sikur të mos isha treguar aq mendjemadhe, aq kryekërcyer. Sikur të mos kisha dashur aq shumë të më lavdërojë mësuesi. Atëhere nuk do të kisha thënë se nuk besoj në zotëra e në astrologji. Dhe atëhere Jupiteri do të më kish lënë fuqitë magjike.

Gjyshja besonte në tjetër zot. Oh gjyshe gjyshe. Ajo më thonte se kur njeriu vdes, atëhere shpirti i shkon tek ata që e duan. Mua më merr malli për gjyshen. Para se te vdiste ajo ruhej nga unë, që të mos më infektojë. Por unë nuk dua të jetoj në një botë ku jam vetëm. Kurvë, ti deshe të kishe fëmijë jo unë. Atë natë unë u ngrita kur tjerët po flinin dhe u shtriva me gjyshen e sëmure. Tata nuk më do. Ai quan mamën kurvë. Ndoshta tata nuk është tata im. Ndoshta mama kish një dashuri tjetër romantike, me dikë që e donte, e përkëdhelte, i fliste fjalë të mira. Dikë që e ndihmonte në shtëpi. Ndoshta ai vdiq dhe mama ishte shtatzanë dhe u martua me tatën dhe linda unë. Tata nuk më do. Ai ndoshta nuk është tata im.

Tashti kam nisur të kollitem. Tata e mama kanë shumë frikë dhe kjo i qetëson pak. Më cojnë në shkollë, se nuk kanë pare për kujdestare dhe na duhen paret. Por nuk grinden më para meje. Sa here kthehem nga shkolla, nuk hyj në shtëpi. Pres pak në oborr. Dëgjoj. Nëse ata janë brenda, kthehem e hyj në shtëpizën e oborrit dhe i lë të mbarojnë. Grindjet e tyre marrin fund zakonisht me të shara. Tata del duke shfryrë. Mama qan. Kur unë hyj brenda, mama fshin lotët dhe më pyet a jam kollitur sot shumë.

Unë i them jo, por më vonë nis kollën prapë. Kolla është fuqia ime magjike. Ajo i qetëson pak mamën e tatën.

Jupiteri është zot i mirënjohjes, shpresës, fatmirësisë. Ai është edhe zot i mëshirës, e është mëshiruar për mua. Mësuesi im i vjeter nuk del më në shkollë dhe mua kjo më gëzon, pse s'dua ta zhgënjë. Ai mendon sigurisht ende se unë nuk besoj në zotëra e në astrologji. Por unë besoj besoj.

Budallaqë budallaqë, gjithcka është faji im. Sikur të mos isha treguar aq mendjemadhe, aq kryekërcyer. Sikur të mos kisha dashur aq shumë të më lavdërojë mësuesi. Atëhere nuk do të kisha thënë se nuk besoj në zotëra e në astrologji. Dhe atëhere Jupiteri do të më kish lënë fuqitë magjike. Dhe tata e mama nuk do të ishin thyer si qelqurina. Unë di gjithcka që do ditur për thyerje qelqesh, se kam thyer vetë shumë sosh. Është lëmia ime e ekspertizës. Dhe di që kur qelqi thyhet një herë. Nuk ngjitet më sërish.

Por nëse vdes, atëhere gjithcka bëhet mirë. Nëse unë kollitem gjithnjë e më shumë, e kam zjarmi, e shtirrem. Nese une mbaroj. Atëhere tata e mama do të ulen pranë meje si dikur. E do të qajnë bashkë për mua. E tata do t'ia vë krahun mbi supe mamës, e ajo do ta vë kryet në krahëror të tij. Kur mendoj për vdekjen time, uroj të vie sa më shpejt. E pikturoj imazhe të varrimit. Një varr i vogël, varri im, i bardhë. Dhe tata e mama të përfaquar përgjithmonë.

Unë do të shkoj të takoj gjyshen. Oh gjyshe.

Ajo do të më presë me gaz. Eja këtu, mbesa ime. Të lumtë moj bijë, bashkove prapë prindërit tu. Paske qenë vërtet vajzë nga Jupiteri.

Karatinga ngujon njerëzit dhe sa herë që ne ngujohemi - për futboll, për orë policore, a për karantinë - shifrat e dhunës familjare pësojnë gjithmonë rritje anëmbanë botës.

Ju lutem mendoni për fëmijët. Çfarëdo ligësi që bëjmë ne të rriturit. Ata gjithmonë mendojnë se është faji i tyre disi. Se kanë hise në gjynahet tona.

Mendoni për fëmijet, ju lutem.



VITI 0001

tregime nga

Xheni Shehaj



1. Viti 0001

I mbijetova përmytjes së madhe. U zgjova në një breg deti. Bashkë me mua ishin disa kafshë e zogj. Një pyllësi e dendur rrethonte gjithë vendin ku po qëndroja. Një zë brumbulloi fuqishëm: "Futu në pyll".

Zoti? Ndjeva djersë mbi shpinë. E njihja historinë e krijimit të njerëzimit por nuk dija si do të shkonte puna ime tani pas përmytjes. Isha i vetmi njeri i mbijetuar. Kafshët që zbritën në tokë me mua, ishin larguar tashmë. Pylli ishte habitati i tyre. Po me mua ç'do të bëhej?!

E lashë mendjen të tirrte pafund dhe bëra siç më urdhëroi zëri. Hyra në pyll. Pemët e larta gati preknin qiellin. Njëherë mendova se kisha vdekur dhe ndodhesha në parajsë.

Pastaj qesha dhe i kujtova vetes se nuk isha aq njeri i mirë sa të meritoja parajsën. Vazhdova të ecja.

Pylli s'kishte mbarim. Pjesa ku po ecja ishte e gjitha e lulëzuar. Të kënaqej syri. Arrita kështu në kufi. Aty mbaronte pjesa e lulëzuar e pyllit dhe fillonte një tjetër. Në atë pjesë të pyllit ishte vjeshtë. Toka ishte mbuluar me gjethe të zverdhura. Pemët ishin gjysëm të veshura. Për të kaluar kufirin më duhej të kapërceja një humnerë. E dija që se bëja dot. Ndaj u ula këmbëkryq mbi tokë dhe prisja që zëri të kujtohej për mua dhe të më drejtonte.

Nuk e di si ndodhi por mendoj se arrita të dremis paksa. Pikërisht gjatë asaj kohe dikush më kishte bartur për leckash e tashmë ndodhesha në pjesën e pyllit ku ishte vjeshtë. Dëgjova kërcitjet e gjetheve poshtë këmbëve të mia.

Rruga zgjati njësoj si ecja në pyllin pranveror. Më pas u përsërit historia por pak ndryshe. Në vend të humnerës kësaj here shtrihej para meje një ujëvarë që derdhej potershëm nga nuk e di se sa metra lartësi. U llahtarisa.

Pastaj m'u kujtua humnera. Mendova se do të më dilte më mirë sikur të dremisja dhe dikush të më jepte një dorë në kalimin e ujëvarës.

Dhe ashtu ndodhi.

Përpara meje shtrihej pjesa e pyllit dimëror. Drurët e zhveshur të kallnin tmerr. Dukej si një pyll fantazëm i zbrazur nga jeta. Eca gjatë. E përshkova deri në fund pyllin dimëror. Teksa ecja mendoja se cila do të ishte prova e radhës. Më në fund arrita. Në kufi me pyllin ishte një hon i thellë prej të cilit dilte zjarr e flakë. U lemerisa. Bëra hapa pas dhe mbeta në pritje. Zëri u dëgjua sërish:

"Hidhu në zjarr. Nuk do të të ndodhë asgjë. Do vish tek Unë. Kjo është prova e fundit. Prova e zjarrit. Ki besim tek Unë. Vetëm nëse hidhesh dhe arrin tek Unë do mund të shkruash historinë. Përndryshe gjithçka mbaron këtu.

Frika më kishte paralizuar. Dridhesha.

-Nga ta di, - i thashë - se nuk do të vdes aty mes flakëve?

-S'ke nga ta dish - m'u përgjigj. -Duhet të besosh verbërisht.

- Më jep një provë, - iu luta.

- Provat ti dhashë gjatë gjithë rrugës por nuk paske besuar. Tani ose hidhu, ose qëndro aty ku je në përjetësi.

Kaq tha zëri dhe nuk e dëgjova më kurrë.

Një rrymë e ftohtë më përshkoi trupin. Vendosa të besoja dhe të hidhesha por sapo iu qasa honit që nxirrte flakë u ktheva pas me lebeti. Hoqa dorë nga hedhja në zjarr. U ula në kopshtin dimëror dhe e lashë veten në dorën e s'di se kujt. Tani jam një shpirt, trupi im nuk i rezistoi dot ngricave dhe dergjet i ngrirë atje poshtë, nën pemë. Shpirti është sipër, në një vend ku s'ka të tjerë dhe nga ku sheh çdo ditë të njëjtën pamje: zbrazëtinë e botës.

Nuk arrita dot ta shkruaja historinë. Ishte thjesht çështje besimi...

2. Rrugëtimi i Ezrës në botën tjetër

Ezra ra të flinte dhe nuk u zgjua të nesërmen as në të njëjtin orar si përditë, dhe as më vonë. Frenku,

maçoku qimekuq, mjaullinte pas derës së mbyllur të dhomës së saj.

- Mjau, mjauuu!

Heshtje. Zbardhëllima u fut ngadalë nëpër xhamat e shtëpisë. Ezra flinte, flinte për të mos u zgjuar më. Por këtë se dinte Frenku, nuk kish si ta dinte. Atij i bëhej se pas pak do të dëgjonte zërin e së zonjës tek i uronte fillimin e ditës së re:

- Mirëmëngjes Frenk! Mirëmëngjes i bukur! Fjete mirë dudush?

Frenku po përdridhej në dysheme njësoj sikur të ndjente duart e Ezrës përsipër tekta e përkëdhelte. Ezra flinte përgjithmonë dhe njëkohësisht përjetonte rrugëtimin në një tjetër dimension.

{Në botën e Ezrës}

Ajo donte të zgjohej. I fliste vetes dhe e kurajonte për të hapur sytë.

- Hapi sytë Ezra! Hapi sytë! Të lutem Zot më zgjo! Ku jam këtu?

Ajo nuk kuptonte ku ndodhej. Me sytë gjithmonë të mbyllur shihte gjëra që kurrë më parë si kishte ndeshur. Një qiell i gjithi për të. Shumë krijesa me krahë të bardhë fluturonin pareshtur nëpër hapësirë. Ezra ndjeu të ftohtë. U përpëliti dhe tentoi të zgjohej. Nuk mundej. Një çast mendoi të lëvizte. Sapo bëri lëvizjen e parë ndjeu se po binte. Po tamam, trupi i saj po lëshohej me shpejtësi drejt një humnerë. Lëshoi një zë aq të frikshëm sa krijesat me krahë të bardhë u shurdhuan. Tamam në kohën kur do të plandosej një dorë e stërmadhe doli nga hiçi dhe e mbërtheu fort.

U ngjit sërish aty ku ndodhej disa sekonda më parë. Sytë i kishte të mbyllur. Për një moment gjatë rënies ishin gati për t'u hapur por sapo mrekullia do të ndodhte u shfaq dora dhe magjia u prish.

Mendja e Ezrës edhe pse e çorientuar kuptoi diçka. Nëse tentonte të rrëzohej sërish mund të hapte sytë, të zgjohej, mjafton që mos t'i dilte ajo dorë e ta mbërthente fuqishëm. Ajo vendosi ta riprovë rënien.

Lëvizti paksa dhe pa e mbledhur mendjen mirë e gjeti veten duke rendur në rënie të lirë drejt humnerës.

Një zhurmë e madhe i tërhoqi vëmendjen. Kishte rënë mbi trupat e krijesave me krahë të bardhë, të cilët kishin krijuar një lloj kordoni në fund të humnerës. Trupi i Ezrës shkaktoi krisje dhe thyerje në krahët e krijesave. Por ajo vetë nuk ndjeu asnjë dhimbje në trupin e saj.

- Nuk e dija që kisha kaq forcë! - mendoi.

Tentoi të hapte sytë. Nuk mundej.

- Po si i shoh këto krijesa, qiellin, dorën që më mbajti kur i kam sytë mbyllur?!

Ishte gati të ulërinte dhe të qante njëkohësisht nga frika e kësaj enigme, kësaj të panjohure që po jetonte. Ishte gati të mbytej në dënësia. Se kuptonte se si mund të qëndronte pezull, gati sa nuk cikle krahët e krijesave fatkeqe, gati sa nuk rrëzohej në humnerën e skëterrshme. Ashtu me sy mbyllur pa dorën që po vinte drejt saj. Kuptoi se pas pak nuk do të shihte më asgjë dhe gjysëm e zalisur lëshoi atë pak zë që i kishte mbetur, i cili jehoi deri në skajet më të largëta të atij qielli të pamatë...

- Zooot!!!

Ndërkohë Frenku vazhdonte të mjaullinte pas derës në kërkim të ushqimit dhe përkëdheljeve të Ezrës.



Kam një ide të ndarë përgjysëm

Kam një ide të ndarë përgjysëm,
ide të ngulmët.
Gjysma e saj është e mysët,
gjysma e lugët.

Jam gati të vdes për njëren gjysëm.
madje dhe verbtas.
Për gjysmën e lugët, gjysmën e mysët
dhe anasjelltas.

Kjo nuk përbën asfarë kundërvënieje,
sido të jetë rasti.
Krejt qenia ime është kundërvënie
e çdo grimëçasti.

E vërteta në do të bashkëjetojë -
ka kushte komploti.
Dy gjysmat idesë le t'i bëjnë rojë
tek unë, i ploti.

27. 02. 2017

Pamjaftueshmëria

shiu është për të gjithë:
fatet janë të ndryshme.
zhurma e ekspresit të kafesë
i përbashkon një grimë
këto arabeska gjaku njerëzor
që kundrojnë përhumbur pas qelqesh
shqelmat e ujshme të kalit hapësinor.

tokë, o rrafsh i së tashmes...
fat, o fytyrë e së panjohurës...
ëndërr, o stacion kalimtar trenash...

ajo që qëndron,
ajo që do qëndrojë -
(dhe duhet të qëndrojë)
është pikëpyetja shtegtare
mbi thekse emocionale
të njëfarë kuptimi,
të njëfarë pandehme,
të njëfarë shprese a ëndërrimi
në kontekstin e përkohshëm të universit
me prenka efemere shirash.

mendimi e shtyn gojën të hapet
dhe ndjen pamjaftueshmërinë e vet
për t'u shprehur.

E përditshme

S'diskutohet më ngasja, instinktet e ngasjes.
As vrasja vetë, por rituali i vrasjes.

S'diskutohet as mllëfi, format e urrejtjes,
por mbytja e ndërgjegjes nga tenja e brejtjes.

Në performancën publike të Meshës së Zezë
thelbi satanik ushtron delikatesë.

S'ka patur e Keqja ushtarë kaq besnikë
të stërvitur në frontin e saj estetik.

Mes terrorit real e terrorit verbal
përpunohet stili vrapar epokal...

2012



ZONJA ASNJERI DHE ZOTI ASKURRKUSH

poezi nga
Agron Tufa



Motivi

krejt çka më nxit me kërkue
asht ekzistenca e një vazoje
të strukun diku, n'terrinën e butë
të pakujtesës sime.
nuk di pse u spraps në kujtesë.
nuk di pse u msheh në pendesë.
nuk di me ç'farna e lashë,
as pse u nguta me dalë jashtë...

por koha e kthimit në shpi
e tjetërsoka njeriun:

kështu na u kthye i bombarduem
ndër pezhishka përvojash një natë
leopold blumi - o me dreqin, o me të birin -
dhe të dy, mandej, nuk njohën
vedin në pasqyrë,
por surratin e shtrembnuem t'shekspirit.

Kështu ta qet gjuhën realiteti i ri,
që ka zavendësue vazon.

Historitë e atyre që s'janë

Historitë e atyre që s'janë
zgjohen bef një ditë, marrin frymë,
bëhen saora erë, erë e fortë,
na shpupurisin, trazojnë,
bëhen furtunë e çmendur,
na shkepim si gjethnajë degësh
e si rrymë konvekse na ngrënë,
na hapërdajnë në qiej të enjtur,
na përndjekin, fshikullojnë,
na dëbojnë shtigjesh të verbër
ku na mbulon lluca, llurba,
dhe ashtu, të kalbur, gërbulur,
nuk e gjejmë më rrugën e kthimit.

Në historitë e atyre që do vijnë,
prej dherash ku jemi shkapetur
do të ngrihet masa jonë e varrosur.

Por as ata nuk i pret fat më i mirë...

10.03.2017

Bloja e hollë e përditës

Sekretesh vogëlane, djajsh çikërrimtarë -
larg turmës me farisej babëzitetë,
ti thur prikën tënde me margaritarë -
blojën e hollë të përditës.

Ditën që engjëjt braktise përfare -
humbe këtu, diell midis hithrash.
Netët vezullore - varg me ruazare -
tingullin e shuajnë në fajanca ditësh.

Plot me ingranazhe sahatësh të vegjël,
koha end paprâ pëlhurën magjike.
Ç'do vdesësh me mua, imcake, o thnegël!
E denjë për tablo mikroskopike.

U ndave nga engjëjt sogjetarë të dritës
të ngjërësh misterin, që këtu të vret.
Prej tij del bloj' e hollë e përditës...
Po kush e mbrun me të veten e vet?

shkurt 2017

Diç e pezullt heq shpirt...

rrebeshet e breshërave të majit rinisën...
kërcet butë faqja poroze e dherave kaf.
sumbujt e bardhë e të fortë shkartinës
zhurmën e shkrimit në shaptilograf.
diç e pezullt heq shpirt mbi klaviaturë,
kërkon një shtrofkë të errët në dhomë,
po atë shtrofkë s'ka për ta gjetur kurrë...
përhapet një aromë bukëvaleje e pjekur
në flegurat e mbushura me athtësi gjaku.
ndihem si të isha një televizor i vdekur,
i flakur shtrembër, në skaj të një parku,
por me det të verbër para shtrëngate.
përfytyrimi përvidehet. erë mes hatullash.
qafa e tendosur struket mes shpatullash
sikur ta priste një mill i gatshëm shpate.
një dorë e padukë, me finesë e me sqimë,
gris velin e bardhë të avujve të shregullt.
tonzura e një kodre shfaqet një grimë
dhe zhytet sërish si murgu në mjegull.
nuk breshëron më. të parët, skërfyell,
spikasin qiparisët dhëmbaçë të kreshtës.
mandej, saora, përshkënditëse nën diell,
të dubluara vërshuan vreshtat e vdekjes.

Qershor 2016


Peizazh

një flad i përzhitur shkumbi lëpin hamulloren.

fluturojnë ulët stërqokat dhe një lingua
sulet shigjetë pas tyre.

mandej
miliona pikëpyetje asgjësuese shiu
ngulen marrafrymas.

ia mbytin fushës përgjigjet.



Kthimi

Kthente poeti në shtëpinë atërore
pas motesh të shumtë mërgimi.
Frynte erë, erë e çmendur.
Kurorat e pemëve i përkulte fort
si krenja të pabindura
pa ia dalë t'i ngjeshte përtokë.
Krifa të shpërvjela gjetnash
tregonin pushin e prapëm të gjetheve
si astarë të atllastë xhaketash.
Diçka po ndoshte me shtëpinë,
diçka, të cilën poeti e sodiste
majë sukës ku kishte stepur -
jo fort larg: një dorë burra,
farefisi, me gjasë,
kishin hequr tjegullat e çatisë,
e tash po shkepnin kafazin,
kafazin e drunjte të brinjëve -
trarë, cungalë, kulmakë -
fije-fije. Bash atëherë,
përnën çati, përposh, braffluan,
u ngritën në ajër qindra flatra,
vërshuan jashtë në krahët e erës.
Elipse të bardhë vërtitëshin mizëri
përreth shtëpisë, në oborr,
mbi çatitë e tjera, kurorat, rrugët,
ngecni midis gjethesh, gardhesh -
tërë lagjja u mbulua me kësi flatrash.
Mandej nisi një shi i dendur, imcak,
me pika të dendura si rruaza çeliku -
dhe flatrat e bardha zunë të shkrehen,
të ngjeshen përtokë, të vishen gëmushave,
në kopshtie, porende ferrash, vija uji.
Dhe vetëm njëra syresh, me krahë -
me gjasë, më të fuqishme se tjerat,
çau ajrin, mbërriti, u plandos
pa frymë ndën këmbët e poetit.
Sikur dha shpirt. Ishte një fletë.
Një nga mijëra fletët e shkruara
me vargjet e hershme
të kohës së trishtuar të djalërisë...

14.03.2017

Trishtimi

mustaqedredhur
e kacadrë
ia beh trishtimi
e rrjedh me rânë
rrëké-rrëké
çdo grimë gëzimi.

Po ndaj të gdhirë -
larashë nën shi
flatrojmë çative;
trishtim'i njelmë
shkund kripë të thatë
në fund të syve.

Na ngushëllojnë
pezull n'ajri
hamendje t'rrasta;
kafshojmë tërbimthi
në lartësi
duar të zbraz'ta.

2016

Marshi i vdekjes

Ky vend popullohet më shumë me të vdekur;
Me të vdekur të lashtë, me të vdekur të rinj:
Janë të vdekur qytetesh me brengë të thekur-
Dhe të vdekur fusharakë e të vdekur - barinj.

Një popull të vdekurish gëlon kësoane;
Të vdekur qyshkuri, të vdekur tani...
Çfarë i mban gjallë vallë, çfarë kambane
I mbledh dhe i derdh nëpër rrugë mizëri?

Të vdekurit ngatërrohen pa pra midis vedit...
Po kush këtë makth do mundë ta zgjidhë vallë?
Vdes ngapak dhe shpresa tek të vdekurit e shtetit -
Më shumë gjysmëvdekur, se sa gjysmëgjallë.

Të vdekurit e lashtë nuk gjejnë dot paqe
Nga të vdekurit mbi dhe, që ngrënë pallate
Mbi eshtra fëmijësh, mbi plazmën e ardhme,
Mbi truallin që zhytet përditë në mëkate.



Portreti nga Bujar Kapllani

*I dasbur Agron,
shumë urime për ditëlindjen,
Redaksia e ExLibris*

Dhe ngrënë rebelimin të vdekurit e vjetër,
Braktisin qimitret, mallkojnë me tërbim
Të vdekurit e rinj, bastardë, kokëngjeshur,
Dhe kthehen qimitresh të pangushëllim.

Ky marsh i të vdekurve nuk paska të sosur,
Me shenjat e tyre, me këngët, me shkrimet,
Që shuhen, rishkruhen dhe mbesin vulosur
Prej bëmave të tyre, gjithsej, vetëm krimet...

Të vdekurit tanë s'e dinë që kanë vdekur
Dhe s'gjendet i gjallë vdekësinë t'u provojë;
Kësoane të gjallët kanë ngrirë të mekur
Nën grushtin e vdekjes që kthen në rrënojë

Lotët, kujtimet, atë shpresë të pakët
Që gjallë mbet dëshirash në urna, saksii...
Të gjallët tash janë, ah, kurme të vakët
Kufomash të gjalla, nxjerrë në liri...

2015

nimfa përballë shkërmoq kallirin e kohës,
shkërmoq kokrra lumturish të tabuizuara
me llërë,
me kofshë,
me gjinj të njomë
nën bluzë,
me buzë,
me njomë
gjestetrazuara,
grimasë e pozë,
me faqet rozë
me gropë,
me ylberë të plotë
vetullash korb e sy
qerpikëgjatë,
me korp si shlligë në vapë
e flokë - grunajë në flad -

aty, në tavolinë përballë,
nimfa-koketë -
statujë rrjedhëse,
plotë jetë -
krijesë fërfëllitëse e Rodenit -
flutur në oxhak,
që ndjell në flakë
pa u djegur vetë.

kalliri i kohës shkërmoqet...
luksi digjet në trill.
nimfa-koketë largohet.
kapakët e syve i mbyll

dhe ndjej:

universi ul qepenat
buzë një honi,
të cilin kam frikë
ta shoh trullosur
nga bedenat.

Moskë, tetor 1995

Nokturn XXIV

Kjo botë e mbyllur nga skaji në skaj -
molusk me buzë të puthitur -
e fsheh të fashitur rrëfenjën e saj
të endet në rrahë të nemitur.

Ne rrekemi t'i qasemi në dhjetra versione,
ne pjekim në mendje hamendje të befta,
dhe mpikset enigma në ekuacione,
dhe hesht në thurimat e saj të sedefta.

Shigjeta e kohës nuk është lineare.
Lotët e djeshëm, sot janë të ndryshëm.
Historia është shapi i shpirtit vetanak -
Qenie me cak të perëndishëm.

2012

KINEMAJA VERORE

tregim nga Muç Xhepa

Po kërkoj në bibliotekën e shtëpisë diçka në shqip. Të shuaj mallin që më ka mbërthyer për dheun tim. Gjëmë e madhe ka rënë mbi njerzisë, "Virusi i Vdekjes". Ndesh me një libër të vjetër, pa mbulesë, "Etër e bij". Humbas në kohë.

- Jam i sigurtë, babait nuk i ka shpëtuar pa e blerë.- Qesh me sytë e zgjuar. Flokët e verdha i ka prerë shkurt.

- E kam lexuar, do ta kërkoj dhe ta sjell menjëherë!

Pak ditë kanë kaluar nga përfundimi i klasës së tetë dhe Ndriçim Nuredini nuk i është zbehur dëshira për të lexuar. Kushtet familjare e pengojnë. Nuk e kanë marrë veten që nga humbja e vëllait të madh, intelektual i formuar, mbaruar për Matematikë. Vdiq i helmuar. Nga një kuti peshku thonë. Dëshpërimin të thellë i është shtuar edhe gjendja e rëndë ekonomike. Kërkoj në raftin e librave, "Etër e bij", botim i Prishtinës, përkthyer nga Shaplllo. Gëzohet shumë kur ia jap. E mban më gjatë se librat e tjerë. Mëson përmendsh pjesë. Te Bazarovi sheh veten.

- Eh, në këtë atom,- Çimi vendos gishtin në ballë,- në këtë pikë matematikore, gjaku qarkullon, truri punon dhe ëndërron të arrijë diçka.

- Bazarovi të paska bërë për vete.

- Çfarë ka rëndësi është që dy herë dy bëjnë katër... pjesa tjetër është e pakuptimtë.

"Çimi lufton me kushtet e jetës". Them me vete. "Djalë i talentuar, futbollist i lindur. Familje e madhe nga Çamëria. E vrrarë e prerë dhe në fund e përzënë prej trojeve shekullore".

Shfletoj librin. Faqe të zverdhura. Aty-këtu ndonjë shënim me laps, të bëra prej Çimit. Pranë fundit fletët janë të ngjitura. I shkëpus me kujdes. Celuloid. Me ngjyra. E afroj pranë dritës së abazhurit. Qesh me vete. Shkëputur nga skena-puthja... Filmi "Helena e Trojës".

"... Eja në liri, eja me mua...". Parisi i shtrirë mbi Helenën.

Ka mbetur e harruar, ashtu mes fletësh. Pata krijuar një koleksion me copza të tilla të grumbulluara gjatë muajve të verës. Punoja si ndihmës operator i Rexhepit te kinemaja verore.

- Kam biseduar me Rexhepin. Do të të marrë ndihmës këto dy muajt e verës.- Më tha babai për të më bërë qejfin. Më pëlqente të shikoja filma.

- Firmose kërkesën dhe shko e fli tani!- Po ngurroja.

- Dëgjo bir! Anglishtja është pa stazh. Vazhdon të lartën direkt, nuk është e nevojshme të aprovolesh prapë.

- Kam bërë rusisht. Pastaj, Shpresa Dushku të tha se kanë edhe një të drejtë studimi tjetër, elektronikë.- Shpresa ishte Sekretaria e Komitetit Ekzekutiv të Rrogozhinës. Ish nxënëse e babait. Ruante respekt për mësuesin e saj dhe donte t'ia shpërblente mundin. Grua e mirë. Lufta e klasës për të ishte kriminale. E tregoi me martesën që bëri. Djalë nga Dedat mori. Të shpronësuar dhe të persekutuar.

- Do mbetesh vetëm me arsim të mesëm. Dëgjomë një herë, të lutem!

- Po e firmos atëherë.- Babai u gëzua. Kishte njëzetepesë vjet mësues në Rrogozhinë.

- Nesër tako Rexhepin!

Ashtu bëra. Më priti me buzëqeshje. Rexhep Nuredini nga Çamëria. Kishte vite në Rrogozhinë. E kishin dëbuar me dhunë nga shtëpia dhe trojet e të parëve. Pushtuesit. Kishin ardhur nga përtej detit. Vetes i kishin vënë një emër të lashtë që s'kishte të bënte fare me ta. Flisnin një gjuhë të sajuar. Gjuhëtarët gjermanë e kishin krijuar. Barbarë. Rexhepi ishte njeri i urtë, gjithnjë i qeshur. Trupin të përkulur, tregues i vuajtjeve që kishte kaluar. Familje e pasur edhe ai, si ajo e Çimit. Në qytet ishte personifikim i kinemasë. Njerëzia i kishin vënë emrin, "Kinemaja e Rexhepit". Fillova ndihmës. Kinemaja verore. Pranë kryqëzimit, në qendrën e qytetit. Një copë vend i vogël rrethuar me mur tulle të lartë. Në ballë ekрани i bardhë, edhe ai prej tulle, por i mbuluar me

suva dhe lyer me gëlqere. Vendet për tu ulur ishin rreshta stolash të gjatë, druri, me mbështetëse prapa, lyer me bojë vaji, jeshile të errët. Ndaheshin në mes prej një rrugice zhavorri që shkonte deri pranë ekranit. Në qoshe, nga e majta e kinemasë, pranë rrugës që të shpie në jug të vendit, ishte hyrja. Një deriçkë kompensate, ku Rexhepi shiste dhe priste biletat.

- Sonte do t'i propozoj Helenës- Çimi përdor emrin e personazhit në film.

- Kanë për të të parë!

- Do e ruaj kur të zërë vend. Gjatë dokumentarit ulem pranë saj.- Vajza, Helena e Çimit, është një nxënëse një vit poshtë nesh. E bukur, e zhvilluar. Sikur të jetë gjimnaziste duket.

- E kam vendosur.- Çimi ka natyrë të hedhur. Trup të lidhur, futbollist. E kam parë të flasë me të tek oborri i shkollës.

- Kujdes! Të refuzon dhe ngatërrosh me njerëzit e saj.

- Çimin s'e refuzon Helena.- Qesh. Seç ka diçka prej Parisi, Çimi. Gen i të parëve. Pellazg.

Një barake e vogël, e mbuluar me llamarinë, shërbente si studio. Aty ishte vendosur aparati i xhimit. Përballë ekranit kishte një dritare të hapur ku nxirrte kokën dritëhedhësi. Aparati ishte prodhim i vjetër sovjetik.

- I Satlini,- thoshte nëpër dhëmbë Rexhepi.

- Kur xhindoset e këput shiritin.

Ditët e para fillova të mësoja si ta përdorja aparatin. Duhej luajtur leva, një manivel në minjaturë, ngadalë në fillim, pastaj duke e shtuar shpejtësinë derisa të arrinte xhiron e nevojshme.- Ashtu fillonte. Ishte një kënaqësi e veçantë ndjenja që provoje kur në ekran shfaqej filmi.

E diel. Java e parë e qershorit. Muzg i freskët. Njerëzia ishin vënë në radhë. Prisin Rexhepin. Edhe Çimi, priste Helenën.

- Sot kinemaja do të mbushet plot. Është film me ngjyra dhe romancë.- Rexhepi fliste më tepër me veten sesa me mua që më ishte drejtuar.

- Është shfaqur shumë, në të gjithë vendin. Do të na hapë punë. Këputet dhe... hajde të dëgjosh të sharat.- Vuri

gërshërët, një shishkë me açiton dhe furçën e vogël në tryezën e punës.

- Po shkoj të hap derën. Vendos dokumentarin në aparat! Do ta shfaq vetë. Ti do të më ndihmosh nëse këputet.- Ishte i tensionuar.

Në fillim u derdhën të rinjtë. Nxitonin të zinin vendet e mesit. Ashtu siç e kishte parashikuar Rexhepi, kinemaja u mbush shpejt. Te stoli i fundit, pranë barakes së xhimit, zuri vend Helena dhe dy vajzat e xhaxhait të saj, më të rritura. Në krye të stolit u ul Helena. Pa mbaruar mirë dokumentari pranë saj ishte ulur Çimi. Nuk e kisha vënë re.

Në Rrogozhinë një lagje e tërë ishte me familjet e përzëna me forcë nga Çamëria. Pas viteve gjashtëdhjetë gjendja e tyre ishte rënduar shumë. Nën zë, ende flitej për grupin "armiçësor" çam. Neroni e kishte quajtur "grup agjenturor". Njëzet vetë. Mes tyre edhe gjeneralin e flotës, Teme Sejkon. Çfarë tragjedie! I marri nuk kishte kufij. Pjesën heroike të kombit, të vrrarë, të prerë me pushtuesin, e kishte dënuar si "agjente të pushtuesit". Dhe nuk ishte mjaftuar vetëm me aq. Gjeneralin e kishte masakruar me sqepar. Mjet të shpikur në epokën e hekurit. I kishte thyer kafkën me të. Vite më vonë do t'i pushkatonte edhe të birin, heroin biblik, trimin e Çamërisë, Sokolin, me fjalët në gojë: "Afrohuni dhe pak dhe shtini...!"

- Më sill volantin me filmin, shpejt!- Rexhepi hoqi dokumentarin nga aparati. Nisi filmin. Heshtja si me komandë pushtoi kinemanë. Kush do ta shijonte më shumë sesa pasardhësit e atyre që shfaqeshin në ekranin filmin? Përse, a nuk ishte Iliada e shkruar në shqip? Homeri në atë gjuhë kishte kënduar. E deklaroi edhe gjuhëtari i dëgjuar austriak, J. Pokorny, një shekull më parë. Titulli dhe fjalët e para të Iliadës: Ili (ylli), As (asht), Meni etj., janë fjalë të gjuhës pellazge/shqipe.

- Minutat kalonin,- më tregon të nesërmen Çimi,- magjia shtohet. Qielli, yjet. Parisi, Helena. Të fshehur pas kaçubeve. Të shtrirë. Puthja, "... Eja në liri, eja me mua...!" Afrova dorën. Pranë saj. Ndjeva gishterinjtë që i dridheshin. Po i afrova pranë të miave. Rrymë tensioni më përshkoi. I tërë trupi m'u drodh. I shtrëngova dorën. Edhe ajo mua. Ngjitëm pëllëmbët! Thurëm gishtërinjtë. O Perëndi!- Çimi tregon dhe mua më duket sikur jam duke lexuar sërish "Etër e bij". Por, krejt ndryshe. Në formën e kundërt të tij. Një Bazarov që dashuron. Larg nihilizmit. Bazarov që sheh pjesën e bukur të jetës.

- Dhe... thika në zemër mu ngulën... të sharat.

- O çam! O i pabesë! Përse e ndalove?

Me të kërcitura filmi u këput. Kinemaja shpërtheu në të shara. Rexhepi i mbuluar në djersë kërkoi që të mbaja njërën anë. Me gërshërët shkurtoi celuloidin e dëmtuar, e ngjiti dhe rinisi filmin. Të sharat u shuan. Copën e dëmtuar e mora unë.



NATA MË BLU SE ÇDO NATË BLU

tregime nga
Roland Gjoza

NATA MË BLU SE ÇDO NATË BLU

Dasma mbaroi më tre të mëngjesit. Përsëri një kalë i bardhë u doli përpara në hyrje të urës Verrizano. Një kalë arab, i lartë, i zhdërvjelltë, me këmbët e para të ngritura lart dhe të përthyer te gjunjët. U ra me thundra xhamave të përparme dhe u ngrit lart si i tërhequr prej një dore të padukshme. Makina s'pësoi asgjë, madje as trandje nuk pati. Ishte a s'ishte? Një fanepsje misteri dhe aq? Gruaja lëshoi një klithmë, ndërsa burri uli kokën mbi timon. Ç'është thotë kjo? pëshpëriti ai. Po ai kalë, kur erdhëm në mbrëmje, tha gruaja. Ndoshta jemi përgjumësh, shohim ëndërra.

U kthyen në shtëpi dhe fjetën.

Të nesërmen nuk mbanin mënd asgjë.

Pas një jave ishin në një dasmë tjetër. Kësaj radhe u doli përpara një gorrillë, si King Kongu. Ndaluan mu përpara syve të tij bojë kafe, me një dritëz në ninëzë, një dritëz qesëndie. Pastaj asgjë. E pe? pyeti burri. E pashë, iu përgjigj gruaja. Këto janë shenja. Për mirë, qofshin. Tani u bënë më të vëmëndshëm. Makinat e parkuara ishin si ato të viteve 30-të. Burrat mbanin frak, papijon. Gratë, fustane të mëdhenj, të fryrë. Burrat i kishin flokët të lëpirë, mustaqet spicë. Gratë flokë të shkurtër me onde. Dikush i binte pianos, një tjetër kontrabasit, dhe një i tretë saksit. Këngë të vjetra, bluz, fokstrot, rumba, tango. Nuk njihnin njeri. Kërçyen, pinë, erdhën në qejf, zunë miq dhe aty kuptuan se ishin në kohën e Ruzveltit. Sapo kishte mbaruar Great Depression. Ishte vërtet për të vënë duart në kokë.

Dasma mbaroi më tre të mëngjesit.

U kthyen në shtëpi dhe fjetën.

Kështu çdo javë. Prej vitit 2011 ata zbrisnin në vitet 30-të.

Makinat e vjetra, gratë me kapele të mëdha, burrat me frak. Dasma të tipit të vjetër. Dhe një hollësi; nata është më blu se çdo natë blu.

Nju Jork 2011

KARANTINA

Ajo ditë ishte fatale për të. I thanë ta linte punën. Nuk pyeti përse ndodhte kjo, sepse i dukej përpjekje e kotë. Punonte prej 13 vjetësh në Nju Jork në një rrokaqiell gjashtëdhjetë e dy katësh. Ishte ende ditë, ora pesë mbasditë, fund shkurti. Kthehu kryet dhe pa hyrjen e rrokaqiellit, përshkoi me mend katet dhe ashensorët, zyrat, banjot. Ishte 42 vjeç. Bënte dy punë në të njëjtin rrokaqiell; paradite si kujdestar ashensori për kompaninë Asa, pasdite në pastrim për kompaninë Fashion Gold.

E kishte dëgjuar mirë shefin? Jo, s'ishte e mundur. Pas 13 vjetësh ishte hera e parë që shikonte dritë

dite. E fillonte punën në 6, po ngrihej që në 4.30, merrte metronë dhe ndërronte tre trena. Hynte në rrokaqiell dhe bëhej gati me kostum të zi, këmbishë të bardhë, kravatë blu. Bënte prova me buzëqeshjen, hapte dhe mbyllte gojën, rregullonte flokët, i jepte vetes energjinë e nevojshme. Mbaronte punën e parë në tre dhe po në tre niste punën tjetër, që e linte në 11. Në shtëpi mbërrinte në 12.30. Ishte mësuar me të gjitha. Ia dinte radhën punës. Çdo vit kishte rritje page. Çekun e javës nuk e prekte me dorë se ai shkonte



Portreti nga Ina Lajthia

drejtpërdrejt në bankë. Rronte me fast fud, 5 dollarë në mëngjes, 3 dollarë në darkë, ujin e pishëm e merrte nga çezmat e zakonshme. Veç e mundonte çmimi i biletës së metrosë; 104 dollarë në muaj. Po s'folëm për të shtunën dhe të dielën. Në punë. Paguhej dyfish. Ëndërra? Të blinte një shtëpi në Amerikë. Po shtëpi, ama.

Një park, ketra, fenerë të ndezur para kohe. Qiell. Pak qiell se e pinin rrokaqiejt. U mahnit. O zot, 13 vjet pa i parë këto gjëra. Donte të ulej në një stol dhe të shikonte ketrat në bar. Iu duk humbje kohe. U kthye mbrapsht. E kishte dëgjuar mirë shefin? Ia kishte thënë vërtet? Po pse duhej ta linte punën kështu papritur? Iu afrua sërish rrokaqiellit, kaloi rojen e sigurisë te hyrja, u ngjit lart, të gjithë të ikur. Zbriti poshtë si i shpartalluar, duke dyshuar, përplot frikë dhe ankth sflitës. Ç'kishte ndodhur? Ja, tani duhet të merrte pluhurat në zyrën e bosit të madh. Do të zvarritej poshtë divaneve prej lëkure për të tërhequr ndonjë bisht cigare. Ishte pushuar nga puna dikush vetëm për një bisht cigare. E ndjente marrëzishëm se duhej të shtrihej barkas. Ishte ora. Duart i dridheshin, e mbuluan djersët. Diçka ishte prishur në atë mekanizmin që punonte me aq përpikmëri. Ç'kishte

ndodhur? Nuk po kuptonte asgjë. Ku të shkonte? Ishte ora e punës, pikërisht ajo koha e rëndësishme kur zvarritej poshtë divaneve prej lëkure në zyrën e bosit të madh. Ia kishin thënë, apo i kishin bërë veshët. E kaploi alarmi. Atë çast një makinë e madhe e kuqe si zjarrfikëse ndaloi para rrokaqiellit dhe prej saj dolën me të shpejtë disa punëtorë me skafandër, me bombola dhe gypa të gjatë nëpër duar. Ata u ngjitën me të shpejtë nëpër ato ashensorë që mirëmbaheshin prej tij. Ç'ka ndodhur? Të gjithë ia kishin mbathur për në shtëpi, ndërsa atij i dukej se pa të ashensorët nuk do të punonin. Duhet të kthehem mbrapsht. Mbrapsht. Dhe ndërsa nxitonte drejt rrokaqiellit, krahas tronditjes së madhe ndjente dhe një gëzim të pashpjegueshëm sikur diçka e prishur po i kthehej normalitetit. Atje e ndali një dorë aspak miqësore. Ishte roja e sigurisë që s'e la të ngjitej lart. Është e ndaluar, i thirri dhe e shtyu jashtë. Mezi merrte frymë. Pa e patur mendjen hyri në një starbaks dhe porositi një kafe. Dridhej i tëri sikur ta kishin zënë ethet. Pastaj kur pagoi paratë dhe tërhoqi kusurin u pendua që mori kafe. S'dinte ç'bënte. Ata punëtorët me skafandra dhe bombola i dukeshin si të ardhur prej ferrit. Ashtu i mbytur në djersë dëgjoji dikë që po i thoshte një tjetri: Është mbushur Nju Jorku me çimka, po dizinfektojnë grataçielet...Kjo s'ka ndodhur kurrë kaq kërcënuese... Ndoshta Nju Jorku mbyllet në karantinë.

Diçka u shëmb pranë tyre. Ishte heroi ynë. Kishte vdekur.

Nju Jork 2011

IRLANDEZI NË AEROPORTIN JFK

Ai u shfaq herët në terminal. Me një karrocë invalidi me bateri. Mbante një qeskë për prostatin, në hundë kishte mbërthyer një llastik, që lidhej me një aparat oksigjeni. I kërkuan pasaportë, po s'kishte. Paraqiti një Green Card të vitit 53. Një copë rreckë që mezi lexohej. Ajo s'vlente. I kërkuan një çertifikatë. Nxorri një shkresë të vjetër, të palosur, gati një mbeturinë letre, çertifikatë e vitit 62. S'kishte biletë avioni.

Ai mezi merrte frymë. Ishte i mbaruar. Duhet t'i kishte tetëdhjetë.

Ju lutem më ndihmoni, thoshte, jam irlandez, shkoj të vdes.

Ishte rregull që gra shtatëzana dhe njerëz të sëmurë të mos udhëtonin. Një vdekje në avion prishte shumë punë. Ai, irlandezi që lutej me aq përulesi, duhet të kishte të paktën një shoqëruar.

Xhejms Hini, menazheri, ishte irlandez. E çuan te ai.

Zotëri, më ndihmo! Dua të shkoj të vdes në vendin tim në Irlandë. S'më ka ecur. Nuk mund të vdes këtu.

Është pak e vështirë, po do të bëj çmos për ty.

I thanë Xhejmsit të bënte kujdes se mund të humbte vendin e punës, në qoftë se plaku vdiste gjatë udhëtimit.

Është irlandez, tha menazheri, ju s'mund ta kuptoni ç'është thotë kjo.

E shoqëroi vetë. E futi në avionin e mbushur plot dhe atje tha; Zotërinj! Ky plak është nisur për të vdekur në Irlandë. Kush do t'i lirojë vendin?

U ngrit menjëherë një djalë i ri.

Do t'iu dëmshpërblejmë, i tha Xhejmsi.

Nuk ka rëndësi, e bëj për babanë tim, që s'shkoi dot në gjallje të vdiste atje.

Njerëzit në avion duartrokitën.

Xhejms Hini humbi punën. Plaku kishte vdekur mbi oqean shumë afër Irlandës.

Nju Jork 2010

Marrë nga: TREGIMET E NJU JORKUT



TË JESH SHKRIMTAR

V. S. Naipaul (Nobel 2001)

Në të vërtetë nuk e di se si u bëra shkrimtar. Mund të jap disa data dhe fakte të caktuara rreth karrierës sime, por vetë procesi mbetet mister. Është e mistershme, për shembull, se si ambicia duhet të ketë lindur e para, dëshira për të qenë shkrimtar, për ta dalluar nga dëshira për famë dhe se kjo ambicie duhet të ketë lindur shumë kohë para se të mund të mendoja për të shkruar.

Mbaj mend se gjatë semestrit tim të parë në Oksford në vitin 1950, bëja për shëtitje të gjata. Kujtoj rrugët, gjethet e vjeshtës, makinat dhe kamionët që kalonin, duke i ngritur gjethet lart ndërsa vrisja mendjen se për çfarë do të shkruaja. Kisha punuar kaq shumë për të fituar bursën për të shkruar në Oksford, për të qenë shkrimtar. Por tani që isha atje, nuk dija për çfarë të shkruaja. Dhe me të vërtetë, mendoj, edhe nëse nxitesha nga nevoja e madhe, diçka e ngjashme me panikun, mund të mos kisha shkruar kurrë. Ideja për ta lënë mënjanë ambicjen për të shkruar ishte shumë qetësuese dhe joshëse ashtu sikurse thuhet se ishte gjumi joshës për ushtarët e Napoleonit gjatë tërheqjes nga Moska.

Më dukej veprim i panatyrshëm të ulesha për të shkruar një libër. Dhe kjo ndjenjë më shoqëron ende, gjatë gjithë këtyre viteve të vona, në fillim të një libri, po flas për një vepër letrare. Nuk ka një temë ose histori të saktë që mendoj por shumë gjëra janë brenda meje: shkruaj me vetëdije fillimet e panatyrshme (artificiale) të shumë librave; derisa më në fund shfaqet në shtysë e vërtetë, atë që kam për ta gjetur, një shtysë e cila më zotëron, dhe më bën që të lundroj sa më larg duke më siguruar punë gjatë gjithë vitit. Dhe kjo është diçka ende e mistershme, që nga e panatyrshmja e duhet të prekësh dhe të nxisësh atë që është më thellë në shpirtin e njeriut, në zemrën dhe kujtesën e dikujt.

Të gjitha format letrare janë të panatyrshme, dhe po ndryshojnë vazhdimisht, për t'iu përshtatur tonit dhe gjendjes shpirtërore të re të kulturës. Në një kohë, për shembull, një person me prirje serioze letrare mund të ketë menduar për të shkruar për teatër; por do të kisha bërë në njëfarë mënyre atë që nuk mundem ta bëj, ta përshtas lëndën letrare në skena dhe akte; nuk do të kisha shkruar për faqen e shtypur, por do

të kisha shkruar "pjesë" për të joshur aktorët dhe, siç më ka thënë dikush që ka shkruar drama, do ta kishte përfytyruar veten (për të lehtësuar procesin e shkrimit) të ulur në një nga vendet në sallë.

Në një kohë tjetër, në një epokë pa radio ose regjistrime, një epokë të mbizotëruar nga libri i shtypur, kush dëshiron të shkruaj do të duhej të formësonte një rrëfim që mund të botohet pjesë-pjesë gjatë shumë muajsh ose të plotësonte tre vëllime. Para kësaj, shkrimtari mund të provoj rrëfime në vargje, ose dramë në vargje, me rima ose pa rima ose vargun epik.

Të gjitha këto forma, të panatyrshme siç duken, do të ngjanin si të natyrshme dhe të drejta për praktikuesit e tyre, ashtu siç bën sot zakonisht romani, sado e panatyrshme të jetë ai, me thjeshtëzimet dhe shtrembërimet, me skenat artificiale dhe idenë që ka për përvojën si një krizë që duhet të zgjidhet përpara se jeta të vazhdojë rrjedhën e vet. Po përshkruaj, pak a shumë, ndjenjën e të panatyrshmes që kisha fare në fillim, kur rreksha të shkruaja dhe vrisja mendjen se cila pjesë e përvojës time mund t'i përshtatej formës, në mënyrën më të fshehtë, si mund ta përshtasja ose të falsifikoja përvojën time për ta përshtatur atë me formën e madhe romanore.

Format e letërsisë janë të nevojshme: përvoja duhet të përcillet në disa mënyra për të cilat është rënë dakord dhe janë lehtësisht të kuptueshme. Por forma të caktuara, si modelet në veshje, ndonjëherë mund të bëhen të skajshme. Dhe pastaj këto forma, larg përvojës së mprehtë dhe ndriçuese, mund të falsifikohen ose t'i ndiesh si barrë. Romancieri Anthony Trollope i periudhës viktoriane i cili po krijon një situatë, është vëzhgues shoqëror, me njohuri të madhe për shoqërinë dhe botën e veprës letrare, me njohuri shumë më të mëdha se ato të Dikensit, është magjepsës. Por unë kam probleme me këtë shkrimtar, i cili, pasi ka krijuar një situatë, vendos ta shpëstjell rrëfimin, thelbin shoqëror ose filozofik të cilin e jep në faqet e para. Më ndodh njësoj si me Thackeray-n: ndiej se si nevoja për rrëfim dhe subjekt janë për të si një barrë mbi shpatulla.

Idetë që ne kemi për kënaqësitë letrare dhe rrëfimin kanë ndryshuar në qindra vitet e fundit apo më shumë. Të gjitha shkrimet e shekullit të kaluar, kinemaja dhe televizioni na kanë bërë më të shpejtë. Dhe shkrimtarët anglezë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të cilët tani më japin kënaqësinë më "romanore", sigurojnë dritare në jetën njerëzore, duke nxitur reflektim, janë shkrimtarë të cilët në kohën e tyre nuk do të mendohej fare se ishin romancierë.

Po mendoj për shkrimtarët si Richard Jefferies, esetë e të cilit për njerëzit që merren me bujqësi mbartin kaq shumë shumë njohuri dhe përvojë sa që shpesh kanë brenda tyre jetë të plota. Ose për William Hazlitt-in, Charles Lamb-in, konkret, i ashpër dhe melankolik, jo eseisti i butë, i pabesueshëm i legjendës. Ose për William Cobbett-in, gazetarin dhe pamfletistin, i cili përpiqet të na jap fshatin nëpërmjet paragjytimeve të mëdha, tablove të qarta të rrugëve dhe të fushave, të njerëzve, të bujtinave dhe të ushqimit. Të gjithë këta shkrimtarë do të kishin pasur dhuntitë e tyre të zbehura ose të lapërdhosura (korruptuara) nga forma romanore ashtu siç ekzistonte në kohën e tyre. Të gjithë ata, romancier siç janë në kënaqësitë që na japin, gjetën format e tyre të shkrimit.

Çdo shkrimtar serioz duhet të jetë original:



shkrimtaru serioz s'mund të kënaqet me krijimin e një versioni të asaj që është krijuar më parë. Dhe çdo shkrimtar serioz, bëhet i vetëdijshëm për çështjen e formës së shkrimit, sepse e di se sado që mund të jetë edukuar dhe nxitur nga shkrimtarët që ka lexuar, format shkrimore që u përshaten përvojave të këtyre shkrimtarëve nuk i përshtaten plotësisht atij.

Philip Larkin-i i vonë, origjinal dhe shumë i madh, veçanërisht në veprën e tij të mëvonshme, mendonte se forma dhe përmbajtja janë të pandashme. Ai thoshte se ka punuar ngadalë: "Je duke zbuluar çfarë të thuash, si dhe si ta thosh, dhe kjo kërkon kohë". Tingëllon e thjeshtë; por thekson një gjë të vështirë: letërsia s'është si muzika, s'është për të rinjtë, s'ka të përkëdhelur në procesin e shkrimit. Dituria ose përvoja që një shkrimtar kërkon të përcjell është shoqërore ose sentimentale, merr kohë, mund të marrë shumë nga jeta e një njeriu, që ta përpunojë atë përvojë, ta kuptojë atë që ai ka kaluar, dhe kërkon shumë kujdes dhe takt, në mënyrë që natyra e përvojës të mos humbas, të mos zbehet nga format e gabuara. Forma të ndryshme shkrimi funksionojnë për të përcjellë mendimet e njerëzve të ndryshëm.

Kam qenë gjithmonë i shqetësuar për problemin e formës, madje edhe të fjalorit, sepse shpejt e kuptova se mes letërsisë që njihja dhe lexoja, letërsia që rrënjosi ambicien time, midis saj dhe jetëshkrimit tim, kishte ndarje, mos-harmoni. Dhe shpejt u bë e qartë për mua se s'bëhej fjalë që thjesht të imitoja format.

Në një nga librat e tij të hershëm Xhejms Xhojsi shkroi për vështirësitë e tij, të heroit të tij me gjuhën angleze. "Ajo gjuhë në të cilën po flasim është e tij para se të jetë e imja. Sa të ndryshëm janë fjalët në *shtëpi*, *Krishti*, *birrë*, *mjeshtëri*, në buzët e tij dhe në të miat! S'mund t'i flas apo shkruaj këto fjalë pa trazim në *shpirt* *Shpirti im ngrihet në hijen e gjuhës së tij*".

Xhejms Xhojsi ishte eksperimentues i kulluar i formës të ndarë nga përmbajtja. Dhe ajo që argumentonte Xhojsi për gjuhën nuk është ajo që po bëj unë. Kurrë s'e ndjeva këtë problem me gjuhën angleze, me gjuhën si gjuhë. Ajo që më shqetësonte ishte fjalori,

kuptimet e ndryshme ose shoqërizimet e fjalëve. *Kopsht*, *shtëpi*, *plantacion*, *kopshtar*, *pronë* e *patundshme*: këto fjalë nënkuptojnë një gjë në Angli dhe diçka krejt tjetër për atë që është nga Trinidad, një koloni bujqësore e cila zhvillon bujqësinë e plantacioneve. Si mund të shkruaja atëherë, në mënyrë të ndershme apo të drejtë nëse fjalët që unë përdorja, me kuptime vetjak për mua, ishin për lexuesin jashtë qëllimit me shoqërizime që mbarteshin nga letërsia më e vjetër? Ndjeva se për të dhënë me të vërtetë atë që pashë, duhej ta përkufizoja veten si shkrimtar apo rrëfimtari, duhej t'i rinterpretoja gjërat. Kam provuar ta bëj gjatë gjithë karrierës time në mënyrë të ndryshme. Dhe pas dy vjetësh punë, kam përfunduar një libër, në të cilin më në fund, mendoj se kam arritur ta përfshij çështjen e riinterpretimit brenda rrëfimit. Qëllimi im ishte e vërteta, e vërteta për një përvojë të veçantë, e cila përmban një përkufizim të vetë shkrimit. Megjithatë, në fund të librit isha i vetëdijshëm se procesi krijues mbetej i mistershëm si kurrë më

parë.

Kritiku francez Sainte-Beuve mendonte se detajet vetjake të jetës së shkrimtarit qartësonin shumë gjëra për shkrimtarin. Kjo metodë e Sainte-Beuve-it u sulmua ashpër nga Proust-i në një libër të çuditshëm, me një formë të çuditshme, origjinale dhe të bukur, pjesërisht autobiografi, pjesërisht kritikë letrare, pjesërisht trillim i titulluar "Kundër Sainte-Beuve-it", ku kritika ndaj kritikut dhe metodës së tij, nxjerr në pah dashurinë e shkrimtarit për letrat, ashtu si edhe elementet autobiografik dhe të trilluar të veprës.

"Kjo metodë", shkruan Proust-i, dhe ai po flet për metodën e Sainte-Beuve-it, "shpërfill atë që na mëson një shkallë shumë e vogël vetënjohjeje, se libri është produkt i një uni tjetër nga vetja që shfaqim në zakonet tona, në jetën tonë shoqërore, në veset tona". Dhe pak më vonë, Proust-i shpjegon: "Ajo që nënkuptohet është se ka diçka më sipërfaqësore dhe boshe në autorësinë e shkrimtarit, diçka më të thellë dhe më përsiatëse në jetën e tij vetjake.... Në të vërtetë, është fshehja e jetës më intime të brendshme, e shkruar në vetmi dhe për veten e vet, ajo që i jep publikut. Ajo që jep në jetën vetjake, sado e stërholluar qoftë, është produkti i një uni mjaft sipërfaqësor, jo i vetes më të brendshme e cila mund të shfaqet duke lënë mënjanë botën dhe veten që viziton botën".


Dhe të bën kureshtar megjithëse nuk është vërtet befasues se pothuajse i njëjti mendim për veten që shkruan të shkrimtarit është shprehur nga një shkrimtar kaq shumë i ndryshëm, Somerset Maugham-i. Në portretin e tij letrar të Thomas Hardy-t, Maugham-i, duke qëlluar mu në shenjë (edhe pse ajo që shkroi u keqpërdor shumë), nduke na treguar për romancierin tragjik të Wessex-it i cili në jetën e tij private ishte ishte tejet i zakonshëm dhe për këtë arsye ishte i mistershëm. "Kisha përshtypjen", përmbledh me pak fjalë mendimin e tij Maugham-i "që njeriu i vërtetë, deri në vdekjen e tij të panjohur dhe të vetmuar, ishte një vegim që u zhdruk në heshtje dhe nuk u pikas dot ai i vërteti i cili qëndronte midis shkrimtarit të librave dhe njeriut që jetoj duke u buqëzeshur në mënyrë ironike të dyja kukullave..."

Përktheu: Granit Zela



Zef Zorba

Princi
botimet



Buzë të ngrira në gaz
poezi